Financuar nga Bashkimi Evropian

Kingdom of the Netherlands

Bashkëfinancuar nga Mbretëria e Holandës

Observatori për të drejtat e fëmijëve

WeBER
Western Balkans Enabling Project for Civil Society Monitoring of Public Administration Reform

RAPORT

VLERËSIMI QYTETAR PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE TË QEVERISJES VENDORE



Ky dokument u mundësua me mbështetjen financiare
të Bashkimit Evropian dhe Mbretërisë së Holandës.
Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund
të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian dhe të Mbretërisë së Holandës.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, Dhjetor 2017

VLERËSIMI QYTETAR PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE TË QEVERISJES VENDORE

Raport për monitorimin e efektivitetit të administratës publike të qeverisjes vendore përmes vlerësimit të mendimit qytetar



Bashkia Tiranë dhe Cërrik

Mbështetur nga:

Financuar nga Bashkimi Evropian

Kingdom of the Netherlands

Bashkëfinancuar nga Mbretëria e Holandës

TIRANË, DHJETOR 2017

Raporti ***"Vlerësimi qytetar për administratën publike të qeverisjes vendore"*** u përgatit nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve (Observatori) me mbështetjen e Bashkimit Evropian (BE) dhe Mbretërisë së Holandës.

"Ky dokument u mundësua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Mbretërisë së Holandës. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Observatorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian dhe të Mbretërisë së Holandës."

Grupi i punës:

Raporti u hartua dhe u përgatit nga ekspertët e Qendrës "Observatori për të Drejtat e Fëmijëve" si më poshtë:

- Zana Kondi - Drejtuese e projektit
- Rezana Shehu – Asistente e koordinatore e projektit
- Julia Alushi – Eksperte e përpunimit të të dhënave
- Elona Mustafaraj – Observatori Elbasan, kordinatore për projektin në Bashkinë Cërrik

Në përgatitjen e këtij raporti dha kontributin e saj **Znj. Marinela Spahiu,** eksperte në fushën e decentralizimit dhe zhvillimit lokal si dhe administrimit publik**,** për hartimin e instrumenteve matës që shërbyen në vlerësimin e treguesve të mendimit të komunitetit mbi efektivitetin e administratës publike të qeverisjes vendore, pasqyruar në këtë raport.

Vullnetarët:

Në shpërndarjen, plotësimin dhe hedhjen në databazë të pyetësorëve dhe intervistave, rezultatet e përpunimit të të cilave paraqiten në këtë raport, u angazhuan vullnetarët si më poshtë:

- Mersi Shehu
- Elona Hoxha
- Adriana Spahiu
- Erta Tërshana

Studio Design "Elvira"

Të drejtat e publikimit

© Aplikimet për marrjen e lejes për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë ose një pjesë të këtij raporti duhet të bëhen pranë zyrave të :

INSTITUTIT PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
Rr. Shenasi Dishnica, 1
PO Box 8177 Tirana, Albania
Tel: +355 4 240 0241
Cel: +355 69 23 12 202
www.idmalbania.org

OBSERVATORIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE
Blv. "Bajram Curri", Nd. 136
H.14, Ap. nr.1
Tiranë, Albania
Tel: +355 4 225 8987
www.observator.org.al

PËRMBAJTJA E LËNDËS

FALENDERIM **4**
LISTA E SHKURTIMEVE **5**
I. LISTA E GRAFIKËVE DHE TABELAVE **6**
A. Grafikët 6
B. Tabelat përmbledhëse të vlerësimit me pikë (1-5) 6
II. HYRJE **7**
III. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE **9**
IV. PROFILI I BASHKISË TIRANË DHE CËRRIK **11**
A. Profili i Bashkisë Tiranë dhe 4 njësive administrative pilot 11
B. Profili i Bashkisë Cërrik dhe 2 njësive administrative pilot 12
V. METODOLOGJIA **14**
a. Mbledhja e informacionit, konsultimi me legjislacionin përkatës dhe dokumentet e nevojshme 14
b. Përcaktimi i fushave dhe parimeve të RAP 14
c. Metodat e përdorura 15
d. Instrumentet matës (pyetësorë dhe intervista për administratën vendore) dhe target grupet 15
e. Qëllimi kryesor dhe rezultatet e pritshme 15
f. Përcaktimi i treguesve për vlerësim 16
g. Analizimi i të dhënave dhe vlerësimi 17
VI. PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE KRYESORE TË PROJEKTIT **18**
A. Çështjet kryesore ku u përqëndrua vlerësimi: 18
B. Shërbimet publike e administrative që u vlerësuan: 18
C. Aktivitetet e realizuara të projektit: 18
D. Realizimi i instrumenteve matës: 19
E. Analizimi i të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve: 20
VII. REZULTATET E VLERËSIMIT TË TREGUESVE **21**
A. Pasqyrimi në mënyrë grafike i treguesve të marrë për vlerësim 21
B. Tabelat përmbledhëse të vlerësimit të treguesve me pikë (1-5) 29
VIII. GJETJET **34**
A. Gjetjet për Bashkinë Tiranë 34
B. Gjetjet për Bashkinë Cërrik 38
C. Gjetjet kryesore 41
IX. REKOMANDIMET **44**
A Rekomandimet e qytetarit 44
B Rekomandimet për qeverisjen vendore – Bashkitë Tiranë dhe Cërrik 44
C. Rekomandime për qeverisjen qëndrore 46
D. Për institucionet e pavarura të administratës publike
X. BIBLIOGRAFIA **47**
XI. SHTOJCA - A **48**
XII. SHTOJCA - B **50**

FALENDERIM

Observatori për të Drejta e Fëmijëve falenderon të gjithë ata që dhanë kontributin e tyre në realizimin e nismës WeBER në kuadrin e zbatimit të Reformës në Administratën Publike (RAP) të qeverisjes vendore me temë *"**Monitorimi i efektivitetit të punës së administratës publike të qeverisjes vendore përmes vlerësimit të mendimit qytetar**"*. Në mënyrë të veçantë falenderojmë qytetarët që morën pjesë në aktivitetet e zhvilluara duke dhënë mendimet, vlerësimet e tyre si dhe duke bërë prezent problemet që i shqetësonin dhe prioritetet e tyre.

Falenderojmë kryetarët e dy bashkive, Tiranë dhe Cërrik, Z. Erjon Veliaj dhe Z. Altin Toska si dhe administratën e tyre që na mbështetën në realizimin e nismës WeBER. Falenderojmë gjithashtu administratorët e 6 njësive administrative pilot në projekt të cilët bashkëpunuan e na krijuan lehtësirat e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve si dhe realizimin e pyetësorëve dhe intervistave për administratën.

Një falenderim i veçantë shkon për Bashkimin Evropian (BE) dhe Mbretërinë e Holandës *që bën të mundur financiarisht realizimin e nismës si dhe koordinatorin për Shqipërinë Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) që na është gjendur gjithmonë pranë duke na ofruar ndihmën e tij të vazhdueshme.*

LISTA E SHKURTIMEVE

BE	Bashkimi Evropian
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
RAP	Reforma në Administratën Publike
RAT	Reforma Administrative -Territoriale
SIGMA	Support for Improvement in Governance and Management
WeBER	Western Balkans Enabling Project for Civil Society Monitoring of Publik Administration Reform
NjA	Njësi Administrative
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
NE	Ndihma Ekonomike
AK	Aftësia e Kufizuar
KP	Konsultimi Publik
PPV	Plani Përgjithshëm Vendor

I. LISTA E GRAFIKËVE DHE TABELAVE

A. Grafikët

1. Grafiku.nr.1: – Pjesëmarrja e qytetarit në procesin e konsultimit publik
2. Grafiku. nr.2: – Mendimi qytetar për marrjen parasysh të rekomandimeve nga qeverisja vendore
3. Grafiku. nr.3 dhe 4– Mendimi qytetar për trajtimin e kërkesave për informacionin
4. Grafiku. nr. 5 – Trajtimi i kërkesave për informacion nga administrata publike e qeverisjes vendore
5. Grafiku.nr.6 – Mendimi i qytetarëve për informacionin që ofron administrata publike vendore
6. Grafiku.nr.7 – Dijenia për mekanizmin e marrjes së mendimit qytetar që siguron cilësinë e shërbimeve
7. Grafiku. nr. 8 – Mendimi qytetar për ofrimin e shërbimeve bazuar në studim të nevojave
8. Grafiku.nr.9 - Mendimi qytetar për sigurimin e qasjes në shërbime të grupeve vulnerabile
9. Grafiku. nr.10 dhe 11 – Mendimi qytetar për kanalet e ofrimit të shërbimeve nga administrata e qeverisjes vendore

B. Tabelat përmbledhëse të vlerësimit me pikë (1-5)

1. Tabela. nr.1 – Vlerësimi i treguesve të përfshirjes së qytetarit në procesin e hartimit të politikave e projektakteve lokale
2. Tabela. nr.2 – Vlerësimi i treguesve të informimit publik
3. Tabela. nr. 3 – Vlerësimi nga qytetarët për burimet më efektive të ofrimit të informacionit
4. Tabela. nr.4 – Vlerësimi i treguesve të mekanizmave që sigurojnë cilësinë e shërbimeve
5. Tabela. nr. 5 - Vlerësimi i treguesve të sigurimit të qasjes në shërbime
6. Tabela. nr.6 – Vlerësimi i kënaqësisë së qytetarit për shërbimet e ofruara në bashkitë pilot

II. HYRJE

Shqipëria, si vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor, aspiron të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian. Këtij synimi i kanë shërbyer zbatimi i një sërë reformash si; reforma në drejtësi, reforma zgjedhore, reforma Administrative - Territoriale e Reforma në Administratën Publike për të cilën është hartuar Strategjia Ndërsektoriale 2015-2020.

Në kuadër të zbatimit të RAP Bashkimi Evropian dhe Mbretëria e Holandës nëpërmjet instrumentit të grantit të vogël WeBER po mbështesin financiarisht vendet e Ballkanit Perëndimor nëpërmjet angazhimit të shoqërisë civile për monitorimin e zbatimit të kësaj reforme në nivel qendror dhe vendor të qeverisjes. Këtij qëllimi i shërben dhe zbatimi nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve (Observatori) i nismës *"Monitorimi i efektivitetit të administratës publike në nivel vendor nëpërmjet vlerësimit të mendimit qytetar "* e cila u zbatua në 2 bashki dhe pikërisht në Bashkinë Tiranë dhe Cërrik gjatë periudhës Qershor – Dhjetor 2017. Zbatimi i kësaj nisme nga ana e Observatorit vjen në vazhdën e realizimit të studimeve dhe vlerësimeve pararendëse në këtë fushë ku do të përmendim disa prej tyre; Raporti mbi studimin[1] e vitit 2017 me temë "Implementimi i ligjit 119/2014 nga 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë" realizuar nga "Qendra për Çështje të Informimit Publik" – INFOÇIP. Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim me mbështetjen e USAID dhe UN WOMEN në vitin 2017 ka bërë vlerësime të komunitetit për qeverisjen vendore në 16 bashki ku pjesë të këtyre vlerësimeve janë edhe e drejta për informimin publik, transparenca dhe pjesëmarrja në vendimmarrje. Një studim tjetër në fushën e informimit publik është realizuar nga Qendra "Respublika" në Dhjetor 2017 me mbështetjen e Civil Rights Defenders dhe fondet e Mbretërisë së Suedisë. Ky studim me temë "Efektiviteti i ligjit për të drejtën e informimit" pati si qëllim monitorimin e zbatimit të ligjit për vitin 2017 duke e krahasuar me studime të mëparshme të zbatimit të tij në vitet 2015 dhe 2016.

Observatori në zbatimin e nismës WeBER ka synuar që nëpërmjet realizimit të takimeve në komunitet, nxitjes së dialogut me qytetarët, ndërveprimit me ta, dhe përdorimit të disa instrumenteve matës të marr mendimin qytetar mbi efektivitetin e punës së administratës publike në nivel vendor, transparencën e qeverisjes, shërbimeve që ofrohen dhe format më efektive të informimit publik që përdor. Gjetjet dhe rekomandimet e kësaj nisme do të ndërgjegjësojnë qeverisjen vendore mbi atë çka mendon qytetari për administratën vendore duke i pasur në konsideratë ato në programet lokale si dhe për mundësinë e zbatimit të studimeve të përcaktimit të nevojave të qytetarëve në mënyrë që strategjitë dhe politikat vendore të hartohen mbi bazën e këtyre nevojave konkrete për të qenë vërtet efektive dhe në shërbim të komunitetit.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve është një organizatë e shoqërisë civile që vjen në zbatimin e nismës WeBER pas një eksperience disavjeçare. Ai funksionon si një OJF e karakterit kombëtar me degët e tij në të 12 qarqet e Shqipërisë.

Qëllimi- Observatori është një qendër që vepron në komunitetin e shoqërisë civile si një organizëm i pavarur, i lirë, jo-fitimprurës, jo-qeveritar me kohëzgjatje të pacaktuar ka si qëllim të promovoj prosperitetin njerëzor të fëmijëve, brezave të ardhshëm në Shqipëri nëpërmjet advokimit, monitorimit të situatave të fëmijëve në Shqipëri dhe vëzhgimit të të drejtave të tyre. Observatori bën analiza, studime e publikime për të ndihmuar dhe përcaktuar prioritetet dhe politika sociale të efektshme të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor që t'u përgjigjen nevojave të tyre konkrete.

[1] http://www.infocip.org/al/wp-content/uploads/2017/10/Raporti-implementimi-i-ligjit-119-nga-61-bash-kite-e-RSH.pdf

Misioni i Observatorit është të vëzhgoj realizimin e të drejtave të fëmijëve në nivel rajonal dhe lokal, të analizoj dhe përpunoj informacionin sipas këndvështrimit të shoqërisë civile dhe të nxisi grupet e interesit për realizimin gjithëpërfshirës të të drejtave të fëmijëve. Mision i Observatorit është edhe nxitja e bashkëpunimit me organizata të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë për çështje të qëllimit primar duke mbështetur dhe inkurajuar bashkëpunimin ndërkufitar, rajonal dhe ndërkombëtar për rritjen dhe zhvillimin e prosperitetit të fëmijëve.

Observatori synon të realizoj objektivat e tij me anë të ekspertizës, hulumtimeve inovative, trajnimeve e konsultave, analizës së informacionit të mbledhur dhe vlerësimin e opsioneve të politikave, advokimit dhe lobimit nëpërmjet programeve të orientuara.

III. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport është strukturuar në 12 kapituj. Në hyrje të tij është përshkruar shkurtimisht kuadri kohor në të cilin realizohet nisma "Monitorimi i efektivitetit të administratës publike në nivel vendor nëpërmjet vlerësimit të mendimit qytetar ". Në këtë pjesë janë paraqitur gjithashtu disa studime të fushës, vlerësime dhe projekte të realizuara nga organizata të shoqërisë civile në drejtim të qeverisjes vendore dhe zbatimit të ligjeve të "Informimit publik" dhe "Njoftimit dhe konsultimit publik" në nivel të qeverisjes vendore e qendrore si dhe një përshkrim i shkurtër i qëllimit, misionit e eksperiencës së Observatorit si një organizatë e shoqërisë civile që zbatoi këtë nismë.

Pjesë e rëndësishme e raportit është edhe përshkrimi i përmbledhur i profilit të bashkive dhe NjA-ve pilot në këtë projekt. Pjesa e metodologjisë shpjegon bazën ligjore, dokumentacionin e konsultuar, metodat e instumentet e përdorura dhe mënyrën e analizimit të rezultateve. Raporti është ilustruar me një seri grafikësh që janë pjesë e analizës së të dhënave si dhe tabela të vlerësimit të mendimit qytetar me sistem pikëzimi 1-5. Gjetjet dhe rekomandimet përbëjnë pjesët finale të raportit dhe janë strukturuar të ndara për secilën bashki dhe në mënyrë të përmbledhur për të dy zonat pilot.

Raporti paraqet ecurinë e procesit të vlerësimit të mendimit qytetar mbi efektivitetin e administratës publike në nivel vendor e parë në kuadër të zbatimit të disa parimeve të RAP. Projekti u zbatua gjatë periudhës kohore Qershor – Dhjetor 2017 dhe zonat e shtrirjes së tij gjeografike janë 2 bashkitë Tiranë dhe Cërrik duke u përqëndruar në 6 njësitë e tyre administrative si më poshtë:

Bashkia Tiranë:

- NjA. nr.5
- NjA. nr. 6
- NjA. Dajt
- NjA. Petrelë

Bashkia Cërrik:

- NjA. Cërrik
- NjA. Gostimë

Zgjedhja e këtyre 2 bashkive nuk ka qenë e rastësishme por është bërë duke u bazuar në faktin që ato si territor i përkasin zonës së Shqipërisë së Mesme. Duke qënë 2 bashki që janë të ndryshme si për nga popullsia, territori por edhe rëndësia na lejojnë për të bërë krahasime të gjetjeve, rezultateve dhe eksperiencave të mira, bazuar gjithnjë në vlerësimin e mendimit qytetar por edhe në zbatimin nga administrata e tyre e RAP në nivel të qeverisjes vendore.

Raporti do t'i ofrojë bashkive Tiranë dhe Cërrik dhe NjA-ve pilot një tablo të asaj që mendojnë qytetarët mbi procesin e njoftimit e konsultimit publik të projekt-akteve lokale, mundësinë e përfshirjes së tyre dhe mekanizmat e përdorura nga administrata publike e qeverisjes vendore, format aktive dhe proaktive të informimit publik si dhe mbi sigurimin e cilësisë dhe qasjes së tyre në shërbime.

Nisma "Monitorimi i efektivitetit të administratës publike në nivel vendor nëpërmjet vlerësimit të mendimit qytetar" u realizua nga Observatori me bashkëpunimin e administratës së bashkive Tiranë dhe Cërrik, NjA-t pilot dhe ajo që është më e rëndësishme me pjesëmarrjen e komunitetit të këtyre njësive.

Qëllimi i projektit: Vlerësimi i mendimit të publikut (banorëve) në lidhje me transparencën e qeverisjes vendore, shërbimet që ofrohen , format më të mira të informimit publik dhe efektivitetin e administratës publike .

Realizimi i nismës kaloi në disa faza si më poshtë:

- ✓ Mbledhja e informacionit, njohja me dokumentacionin e nevojshëm (PPV 2015-2020, buxhetet e vitit 2017), konsultimi me legjislacionin, dhe faqet zyrtare të bashkive dhe NjA-ve pilot
- ✓ Takimet prezantuese të nismës me qytetarët dhe nxitja e dialogut me ta
- ✓ Takimet prezantuese të nismës me administratën publike vendore të bashkive e NjA-ve pilot
- ✓ Realizimi i 325 pyetësorëve dhe 52 intervistave për administratën publike të qeverisjes vendore
- ✓ Përpunimi e analizimi i të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve
- ✓ Takimet ballafaquese administratë publike-komunitet dhe ai përmbyllës
- ✓ Gjetjet dhe rekomandimet

Monitorimi i efektivitetit të administratës publike vendore përmes vlerësimit të mendimit të qytetarit është një vlerësim i këndvështrimit të publikut që nxit llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e administratës. Ky proces bën të mundur shprehjen e mendimit të komunitetit përsa i përket informimit, komunikimit, pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe ofrimit të shërbimeve publike e administrative. Vlerësime të këtij lloji duke u realizuar në mënyrë periodike ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të procesit të demokratizimit dhe përmirësimin e shërbimeve publike duke rritur standardet, cilësinë e shumëllojshmërinë e tyre.

Përfituesit e zbatimit të nismës WeBER janë në radhë të parë qytetarët por edhe qeverisja vendore e administrata e saj. Vlerësimi i mendimit qytetar për administratën publike të qeverisjes vendore i jep mundësi komunitetit të shpreh opinionin e tij mbi politikat, strategjitë lokale, planet e zhvillimit, shërbimet publike e administrative të ofruara, cilësinë dhe efiçensën e tyre si dhe sa ato plotësojnë nevojat e tyre reale. Ky vlerësim krijon gjithashtu mundësinë e monitorimit të efektivitetit të punës së administratës publike vendore, përmbushjen e detyrimeve dhe angazhimeve të saj të përcaktuara me ligj. Nga ana tjetër për autoritetet vendore dhe administratën e tyre vlerësimi i mendimit qytetar ofron mundësinë të njohin më mirë nevojat dhe përparësitë e banorëve të tyre në përgjithësi dhe të grupeve në nevojë në veçanti.

Rezultatet e këtij vlerësimi nuk janë përfaqësuese për popullsinë e dy bashkive pilot, Tiranë dhe Cërrik, dhe administratën përkatëse por shprehin vetëm mendimin e të anketuarëve dhe të intervistuarëve në të 6 NjA-t e shtrira në zonën urbane dhe rurale të këtyre bashkive. Formatet në pdf të modeleve të pyetësorëve për 3 target grupet (qytetarët, biznesi dhe OJF-t) dhe modeli i intervistës për administratën publike të qeverisjes vendore janë të aksesueshme për publikun dhe të gjithë të interesuarit në faqen e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve www.observator.org.al

IV. PROFILI I BASHKISË TIRANË DHE CËRRIK

A. Profili i Bashkisë Tiranë dhe 4 njësive administrative pilot

Tirana është kryeqyteti i vendit dhe bashkia më e madhe në vend si për nga popullsia, ashtu edhe nga territori. Qyteti i Tiranës është zemra ekonomike e Shqipërisë, me përqëndrimin e numrit më të madh të bizneseve në shkallë vendi si dhe me zhvillimin e industrisë së lehtë. Fuqia ekonomike e Tiranës dallohet te sasia shumë më e lartë e kursimeve dhe e kreditit në rang kombëtar, tek të ardhurat tatimore, të cilat në masën dërrmuese realizohen në Tiranë si dhe tek zhvillimi i sektorit të ndërtimit. Numri i bizneseve të regjistruara është 41583 dhe numri i shoqatave dhe fondacioneve të regjistruara është 2209[2].

Sipërfaqja e Bashkisë Tiranë është 1,110.03[3] km[2]. Tirana përbëhet nga 24 njësi administrative nga të cilat 11 janë urbane dhe 13 rurale (Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhita, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri) në të cilat përfshihen 135 fshatra. Popullsia e Tiranës për vitin 2016[4] kap shifrën 793,133 banorë. Në bashkinë Tiranë sipas të dhënave të marra nga QEZHEF[5] , dhe portalit Open Data për vitin 2016 rezulton që ka 31 çerdhe publike dhe 136 kopshte publike.

Njësitë administrative në të cilën është shtrirë zbatimi i projektit janë:

Njësia Administrative nr.5:– Kjo njësi ndodhet në qendër të qytetit të Tiranë dhe përbëhet nga 3 lagje: Blloku, Selita dhe Tirana e re. Popullsia për vitin 2016[6] është 85,728 banorë dhe 30,135 familje. Në këtë njësi janë 2 çerdhe publike përkatësisht nr.16 dhe 57 dhe do të shtohet edhe një çerdhe për zonën e Komunës së Parisit. Ky shërbim nuk i plotëson nevojat e banorëve pasi numri i fëmijëve të grupmoshës 0-3 vjeç për vitin 2016 është 2763. Numri i kopshteve publike është 7[7]. Për vitin 2017[8] numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike është 281 dhe numri i personave përfitues të aftësisë së kufizuar (AK) është 418.

Njësia Administrative nr. 6:– Kjo njësi shtrihet në periferi të qytetit të Tiranës dhe përbëhet nga disa lagje; Kombinat, Yzberisht dhe zona e Astirit. Popullsia për vitin 2016 është 73,240 banorë dhe 23,916 familje. Në njësinë administrative nr.6 ka vetëm një çerdhe publike (nr.4) si dhe një grup për fëmijët e grupmoshës 2-3 vjeç të vendosur në katin e parë të kopshtit publik nr.42. Shërbimi i çerdheve publike edhe në këtë njësi nuk plotëson nevojat pasi numri i fëmijëve për grupmoshën 0-3 vjeç për vitin 2016[9] është 2824. Numri i familjeve që trajtohen me NE për vitin 2017[10] është 405 dhe numri i personave që përfitojnë AK është 541, verbëri 174 dhe paraplegjik 79. Kjo njësi ka si prioritet urbanizimin meqenëse një pjesë e territorit të saj i përket zonës rurale.

2 Të dhënat nga portali Open Data për vitin 2016
3 http://zgjedhje2015.reporter.al/profili-i-bashkise-Tirane/
4 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (MB)
5 Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve
6 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (MB)
7 Sipas NjA nr.5 dhe DAR -Qyteti për vitin 2015
8 Sipas sektorit të ndihmës e përkrahjes sociale pranë NjA nr.5
9 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (MB)
10 Sipas sektorit të ndihmës e përkrahjes sociale pranë NjA nr.6

Njësia Administrative Petrelë[11]: - Petrela bën pjesë në zonën fushore - kodrinore dhe është 15 km larg qytetit të Tiranës. Sipërfaqja e përgjithshme është 6800 ha. Petrela shtrihet përgjatë rrugës nacionale Tiranë-Elbasan përbëhet nga 17 fshatra. Popullsia e njësisë për vitin 2016, sipas Drejtorisë së Përgjithshme të të Gjendjes Civile, është 6615 banorë dhe 1859 familje. Kjo zonë ka kalanë e Petrelës si një pikë e rëndësishme turistike. Aktivitetet kryesore të zonës janë bujqësia dhe blegtoria. Petrela ka burime të konsiderueshme njerëzore, potenciale prodhuese dhe asete të shumta që mundësojnë një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të zonës. Për vitin 2017[12] trajtohen me NE 94 familje, me PAK 70 individ, të verbër 14, invalid pune 71. Njësia Petrelë ka probleme me infrastrukturën që lidh fshatrat e saj ku është e nevojshme ndërtimi i rrugëve. Shërbimi i çerdheve publike mungon në këtë njësi ndërsa shërbimi i kopshteve publike ka nevojë për përmirësim në drejtim të rehabilitimit të ndërtesave, kushteve të brendshme dhe pajisjet. Sipas open data[13] për vitin 2016 numri i bizneseve të regjistruara është 598 ndërsa numri i shoqatave dhe fondacioneve të regjistruara që veprojnë në këtë njësi është 6.

Njësia Administrative Dajt[14]: - Njësia bën pjesë në zonën kodrinore dhe ka një sipërfaqe prej 24 km^2. Brenda territorit të njësisë përfshihen 13 fshatra me një popullsi prej 16,026 banorë dhe 4638 familje për vitin 2016[15]. Njësia Dajt ka funksione të rëndësishme për peisazhin natyror që ka i cili shërben për argëtim e çlodhje për banorët e Tiranës por shërben edhe si një pikë e rëndësishme turizmi. Teleferiku është një element lehtësues për të vizituar dhe shijuar panoramën që ofron mali i Dajtit. Parku kombëtar i Dajtit shërben si një potencial ekonomik për zhvillim. Në këtë njësi janë asfaltuar 67 km rrugë. Në planin e zhvillimit është i rëndësishëm investimi në infranstrukturë jo vetëm në rrugën nacionale por edhe ato kryesore dhe të fshatrave. Edhe në këtë njësi mungon shërbimi i çerdheve publike. Zona e Qesarakës si një zonë e re urbane ka nevojë për plotësim të shërbimit të çerdheve dhe kopshteve publike. Sipas aplikacionit të Bashkisë Tiranë open data numri i bizneseve të rregjistruara është 106 dhe numri i shoqatave dhe fondacioneve të regjistruar që veprojnë në këtë njësi është 1.

B. Profili i Bashkisë Cërrik dhe 2 njësive administrative pilot

Bashkia Cërrik ka një sipërfaqe prej 189.65 km^2. Ajo shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore në përgjithësi mes dy lumenjve, Shkumbin dhe Devoll. Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Cërrik, Gostimë, Mollas, Shalës dhe Klos. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Elbasanit dhe qarkut të Elbasanit. Popullsia e bashkisë për vitin 2016[16] është 47,432 banorë. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 28 fshatra. Në vitet 90 rafineria e naftës dhe Instituti i Duhanit pushuan së ekzistuari duke sjellë largimin e pjesës më të madhe të rinisë nga ky qytet ndërsa pjesa e mbetur e popullsisë ka burime shumë të pakta ekonomike nga pensionet, ndihma ekonomike dhe remitancat. Zona e Cërrikut po përfiton aktualisht nga projekti i hidrocentralit të Banjës mbi lumin Devoll. Në Bashkinë Cërrik ushtrojnë aktivitetin e tyre 2 organizata të shoqërisë civile.

Njësia Administrative Cërrik:- Njësia Cërrik është e shtrirë në qytetin e Cërrikut. Popullsia e saj për vitin 2016[17] është 15,008 banorë dhe 4890 familje. Në këtë njësi shërbimi i çerdheve publike mungon dhe funksionon vetëm 1 kopësht publik me godinë më vehte. Njësia Cërrik[18]

11 Plani i Përgjithshëm Vendor – Bashkia Tiranë
12 Sipas sektorit të ndihmës e përkrahjes sociale pranë NjA nr.5
13 Aplikacion I faqes zyrtare të Bashkisë Tiranë
14 Plani i Përgjithshëm Vendor – Bashkia Tiranë
15 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (MB)
16 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (MB)
17 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (MB)
18 Të dhënat janë marrë nga NjA. Cërrik për itin 2017

trajton 374 familje me NE dhe 245 persona përfitojnë AK.

Njësia Administrative Gostimë: - Njësia Gostimë ka shtatë fshatra. Popullsia e Gostimës për vitin 2016[19] është 12,907 banorë dhe 3635 familje. Banorët e komunës merren kryesisht me kultivimin e bimëve bujqësore si drithëra buk, perime, pemëtari e bimë foragjere. Më të zhvilluara janë vreshtaria dhe ullishta. Në territorin e Komunës operojnë 100 biznese të vogla. Në njësinë Gostimë shërbimi i çerdheve publike mungon. Në këtë njësi administrative funksionojnë 2 kopshte publike të sistemuara brenda shkollave publike 9-vjeçare, 6 shkolla 9-vjeçare dhe një shkollë e Mesme e Përgjithshme në fshatin Gostimë. Numri i familjeve që trajtohen me NE është 120[20] ndërsa numri i përfituesve të AK është 290.

19 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (MB)
20 Të dhënat janë marrë nga NjA. Gostimë për vitin 2017

V. METODOLOGJIA

a. Mbledhja e informacionit, konsultimi me legjislacionin përkatës dhe dokumentet e nevojshme

Zbatimi i nismës WeBER filloi me mbledhjen e informacionit për secilën bashki dhe NjA. pilot. Paralelisht u konsultua legjislacioni përkatës dhe disa dokumente të rëndësishme si më poshtë:

- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
- Ligji nr.115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit publik"
- Ligji nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"
- Ligji nr.9131 "Për rregullat e etikës në administratën publike"
- Dokumenti i SIGMAS, Parimet e Administratës Publike[21]
- Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020

b. Përcaktimi i fushave dhe parimeve të RAP

Për vlerësimin e mendimit qytetar nga grupi i punës së projektit u përcaktuan 3 fusha të RAP si dhe 4 parime sipas fushave përkatëse si më poshtë:



- **Zhvillimi i politikave dhe Koordinimi:**
  - ✓ Politikat dhe legjislacioni hartohen në një mënyrë gjithpërfshirëse e cila mundëson pjesëmarrjen aktive të shoqërisë dhe mundëson koordinimin e perspektivave brenda Qeverisë
- **Llogaridhënia:**
  - ✓ E drejta për informim publik është dekretuar në legjislacion dhe aplikohet vazhdimisht në praktikë.
- **Ofrimi i shërbimeve:**
  - ✓ Ekzistojnë mekanizma për sigurimin e cilësisë së shërbimeve publike

[21] SIGMA, Parimet e Administratës Publike http://www.sigmaweb.org/publications/Principles-Public-Administration-Overview-Alb.pdf

- ✓ Sigurohet qasja në shërbimet publike

c. Metodat e përdorura

- Takime prezantuese me staf të administratës publike vendore të 2 bashkive (Tiranë dhe Cërrik)
- Takime prezantuese me stafin e administratës publike të 6 NjA-ve pilot në projekt
- Takime prezantuese të nismës dhe dialoguese me komunitetin e secilës NjA pilot

d. Instrumentet matës (pyetësorë dhe intervista për administratën vendore) dhe target grupet

- Realizimi i 325 pyetësorëve përkatësisht 253 për Bashkinë Tiranë dhe 72 për Bashkinë Cërrik ndarë si më poshtë:
  - ✓ Qytetarët (mbi 18 vjeç)
  - ✓ OJQ-të
  - ✓ Biznesi (i vogël)
- Realizimi i 52 intervistave me staf të administratës publike të qeverisjes vendore e përkatësisht 41 për Bashkinë Tiranë dhe 11 për Bashkinë Cërrik.
- Pyetjet në pyetësorë i referohen periudhës kohore 2015 - 2017

e. Qëllimi kryesor dhe rezultatet e pritshme

Qëllimi i projektit: Vlerësimi i mendimit të publikut (banorëve) në lidhje me transparencën e qeverisjes vendore, shërbimet që ofrohen , format më të mira të informimit publik dhe efektivitetin e administratës publike.

Rezultatet:

- Rritja e sensibilizimit dhe përgjegjshmërisë së qeverisjes vendore për atë çka mendon qytetari përsa i përket shërbimeve, politikave, strategjive, investimeve, formave të informimit, dhënies së llogarisë dhe efektivitetit të administratës publike. Kjo do t'i hapi rrugën dhe zbatimit të studimeve të përcaktimit të nevojave në mënyrë që strategjitë dhe politikat vendore të hartohen mbi bazë të këtyre nevojave konkrete për të qenë vërtet efektive dhe në shërbim të komunitetit.
- Nxjerrja e rezultateve konkrete, përmes zhvillimit të dialogut (takimet e hapura dhe ato ballafaquese) dhe përdorimit të instrumenteve matës (pyetsorë dhe intervista), në lidhje me vlerësimin e mendimit të publikut përsa i përket transparencës së qeverisjes vendore, cilësisë dhe efektshmërisë së shërbimeve që ofron ajo, efektivitetit të punës së administratës publike në përgjigje të nevojave të qytetarëve si dhe për format më të mira të informimit publik në përputhje me vendndodhjen dhe mundësitë që ka qytetari për të qenë në kontakt me to.
- Zbatimi i këtij projekti synon të ndikojë në ndërgjegjësimin e banorëve për pjesëmarrje në vendimmarrje, për rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj qeverisjes, për zbatimin e iniciativave qytetare në drejtim të kërkesave për shtim të sasisë dhe cilësisë së shërbimeve publike sa më pranë qytetarit dhe sa më efektive duke ndihmuar kështu në përmirësimin e mirëqenies së tyre.

- Projekti ndonëse do të jetë pilot në Bashkitë Tiranë dhe Cërrik rezultatet e tij do të shërbejnë si një shkëmbim i eksperiencave dhe praktikave më të mira për këto 2 njësi të qeverisjes vendore por edhe si model zbatimi për bashki të tjera përsa i përket reformës së administratës publike.

f. Përcaktimi i treguesve për vlerësim

Treguesit që u përcaktuan për vlerësim të ndarë sipas parimeve të RAP ku u përqëndrua projekti, pasqyrojnë mendimin e qytetarëve të anketuar dhe janë renditur si më poshtë:

❖ *Politikat dhe legjislacioni hartohen në një mënyrë gjithpërfshirëse e cila mundëson pjesëmarrjen aktive të shoqërisë*

- Pjesëmarrja e qytetarit në procesin e hartimit të politikave dhe projekt-akteve lokale
- Mendimi qytetar mbi informacionin shoqërues që ofron administrata për çështjet që janë pjesë e konsultimeve publike
- Marrja në konsideratë nga qeverisja vendore e rekomandimeve/komenteve të qytetarëve gjatë procesit të konsultimeve publike lokale

❖ *E drejta për informim publik është dekretuar në legjislacion dhe aplikohet vazhdimisht në praktikë.*

- Informacioni i ofruar nga administrata publike siguron informim publik të mjaftueshëm për komunitetin
- Mendimi i qytetarit për respektimin nga administrata e afatit të përgjigjeve për kërkesat e tyre për informacion
- Numri i kërkesave për informacion të refuzuara dhe që nuk i është dhënë përgjigje fare nga administrata
- Pagesa për marrjen e informacionit të kërkuar
- Burimet më efektive sipas qytetarit për marrjen e informacionit të ofruar nga administrata

❖ *Ofrimi i shërbimeve:*

- Njohja e mekanizmit të marrjes së mendimit qytetar (anketimet) të përdorur nga administrata publike e qeverisjes vendore për cilësinë e shërbimeve të ofruara
- Rishikimi/ridizenjimi i shërbimeve nga administrata bazohet në monitorimin dhe vlerësimin e qytetarëve
- Sigurimi nga administrata i qasjes në shërbime të grupeve vulnerable[22] në përputhje me nevojat e tyre.
- Ngritja, funksionimi dhe aksesi për të gjithë i one-stop shop-ve (shërbimit me shumë sportele)
- Mendimi i qytetarit mbi kanalet zgjedhëse të ofrimit të shërbimeve nga administrata e qeverisjes vendore.

[22] Të moshuarit, personat e paaftë (PAK), gratë dhe fëmijët në nevojë

g. Analizimi i të dhënave dhe vlerësimi

- Nga përpunimi i pyetësorëve dhe intervistave përgjatë muajit Nëntor u realizuan një sërë të dhënash nga të cilat u përcaktuan treguesit[23] e përmendur më sipër dhe u bë vlerësimi i tyre në dy mënyra:
- Vlerësimi i treguesve për nga pesha e tyre sipas përgjigjeve të dhëna nga qytetari, biznesi, OJF-të dhe administrata e qeverisjes vendore (në % dhe në formë numerike)
- Vlerësimi i treguesve nga vetë qytetarët sipas një shkallë pikëzimi 1-5 (ku 1 është vlerësimi më i ulët dhe 5 vlerësimi më i lartë) si dhe vlerësimi nga administrata publike e qeverisjes vendore si ofruese e shërbimeve.



Bashkia Tiranë dhe Cërrik

[23] Pika VII/f

VI. PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE KRYESORE TË PROJEKTIT

Nisma WeBER u zbatua duke kaluar në disa etapa të detajuara si më poshtë:

A. Çështjet kryesore ku u përqëndrua vlerësimi :

Çështjet kryesore ku u fokusua vlerësimi janë si më poshtë:

Koordinimi dhe zhvillimi i politikave	Llogaridhënia	Ofrimi i shërbimeve
Politikat dhe legjislacioni hartohen në një mënyrë gjithpërfshirëse e cila mundëson pjesëmarrjen aktive të shoqërisë	E drejta për informim publik është dekretuar në legjislacion dhe aplikohet vazhdimisht në praktikë.	Ekzistojnë mekanizma për sigurimin e cilësisë së shërbimeve publike Sigurohet qasja në shërbimet publike

B. Shërbimet publike e administrative që u vlerësuan:

Shërbimet publike dhe administrative ku është përqëndruar marrja e mendimit të komunitetit, bazuar në kopetencat dhe funksionet[24] e qeverisjes vendore, janë si më poshtë:

- Çerdhet publike (administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në çerdhe)
- Kopshtet publike (administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte)
- Shërbimet sociale (shërbimet administrative për aplikim të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe Aftësinë e Kufizuar AK)
- Shërbimi i gjendjes civile (procedurat administrative)
- Shërbimet administrative për dhënie të lejeve, liçensave dhe vërtetimeve për pagesat e taksave dhe tarifave

C. Aktivitetet e realizuara të projektit:

Me qëllim sensibilizimin e administratës publike vendore dhe komunitetin e njësive administrative pilot mbi qëllimin e projektit dhe rezultatet e pritshme si dhe nxitjen e dialogut u realizuan aktivitetet si më poshtë:

a. Në nivel bashkie: - janë realizuar 2 takime me staf të administratës qëndrore publike të Bashkisë Tiranë dhe Cërrik në muajt Korrik dhe Gusht. Në Bashkisë Tiranë janë bërë takime dhe intervista individuale me koordinatorin e informimit publik, përgjegjësin për konsultimin publik pranë Drejtorisë së Komunikimit me Qytetarin, Drejtorin e

[24] Ligji nr.139/2015, neni 23 pika 12 dhe neni 24 pika 1

Zhvillimit dhe Kujdesit pranë QEZHEF[25], ekspert në Drejtorinë e Përfshirjes Sociale dhe Drejtorin e Vlerësimit të Detyrimeve Tatimore pranë DPTTV[26]-së. Në Bashkinë Cërrik është bërë takim me Drejtoren e Përgjithshme e cila mundësoi dhe koordinoi takimet në NjA-t pilot.

b. Në nivel njësie administrative: - Gjatë periudhës Korrik – Shtator janë realizuar 5 takime me stafin e administratës së 4 Njësive Administrative të Bashkisë Tiranë pilot në projekt (NjA[27]. nr.5, 6, Dajt dhe Petrelë) dhe 1 takim i përbashkët me administratën e NjA-ve Cërrik dhe Gostimë të Bashkisë Cërrik.

c. Në nivel komuniteti: - Në Bashkinë Tiranë në muajt Shtator –Tetor janë realizuar 6 takime me qytetarët e njësive pilot e përkatësisht 2 takime në 2 njësitë rurale (Dajt dhe Petrelë), 4 takime në njësitë administrative nr. 5 dhe nr. 6 duke qenë se janë 2 njësitë më të mëdha urbane të bashkisë. Është realizuar edhe 1 takim me 10 OJF në Tiranë. Pjesëmarrja qytetare në këto takime si total ishte 84 banorë. Në Bashkinë Cërrik u realizuan nga 1 takim në NjA. Gostimë dhe Cërrik në muajin Tetor me një pjesëmarrje qytetare prej 31 banorë.

d. Takim trajnues: Në muajin Gusht u realizua trajnim 1-ditor me vullnetarët të cilët realizuan shpërndarjen dhe plotësimin e pyetësorëve për qytetarët dhe intervistave për administratën publike vendore.

e. Takimet ballafaquese administratë - komunitet: Në muajin Nëntor u realizuan 2 takime ballafaquese administratë –komunitet në Bashkitë Tiranë (me 32 pjesëmarrës) dhe Cërrik (31 pjesëmarrës) ku u prezantua ecuria e zbatimit të nismës WeBER, gjetjet e dala nga takimet dhe rezultatet e analizimit të të dhënave paraprake. Qëllimi i këtij takimi ishte nxitja e dialogut administratë – komunitet, diskutimi mbi gjetjet dhe rezultatet.

f. Takimi përmbyllës: Në muajin Dhjetor u realizua takimi përmbyllës i projektit në Tiranë me (42 pjesëmarrës). Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të administratës vendore të 2 bashkive e NjA-ve pilot, qytetarëve, OJQ-ve, institucioneve publike lokale, autoriteteve rajonalë dhe IDM[28]-s. Në këtë takim u realizua dhe prezantimi i rezultateve përfundimtare, gjetjet dhe rekomandimet.

Të gjitha aktivitetet e zhvilluara janë bërë publike shoqëruar me fotot përkatëse dhe janë të aksesueshme në faqen e facebook të Observatorit Observatori për të Drejtat e Fëmijëve/ Observatory for Children's Rights dhe në faqen zyrtare www.observator.org.al

D. Realizimi i instrumenteve matës:

Në të njëjtën kohë me takimet u hartuan instrumentet matës; pyetësorët dhe intervistat për administratën publike. Pyetësorët u hartuan në 3 modele të ndarë për 3 target grupe:

a. Pyetësorë për qytetarët

b. Pyetësorë për biznesin

c. E. Pyetësorë për OJF-të

25 Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijës – Bashkia Tiranë
26 Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore – Bashkia Tiranë
27 Njësi Administrative
28 Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim

Pyetësorët dhe intervistat në përbërjen e tyre përmbajnë 4 seksione, 3 nga të cilat përkojnë me 3 fushat që janë marrë për vlerësim si më poshtë:

- Seksioni A – Të dhëna të përgjithshme
- Seksioni B – Njoftimi dhe konsultimi publik
- Seksioni C – Informimi publik
- Seksioni D - Ofrimi i shërbimeve

Gjatë muajit Shtator – Tetor u printuan, shpërndanë, plotësuan dhe u hodhën në databazë 325 pyetësorë nga të cilat 253 për Bashkinë Tiranë dhe 72 për Bashkinë Cërrik. Shpërndarja e plotësimi i instrumenteve matës u realizua falë angazhimit të vullnetarëve. Paralelisht me pyetësorët u realizuan dhe 52 intervista me staf të administratës publike të bashkive qëndrore dhe NjA-ve pilot.

E. Analizimi i të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve:

Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve dhe intervistave u realizua përgjatë muajit Nëntor. Analizimi i tyre dhe nxjerrja e rezultateve përfundimtare vazhdoi përgjatë muajit Dhjetor. Në këtë proces u analizuan 13 treguesit që janë përcaktuar në germën (f) të kapitullit të metodologjisë.

VII. REZULTATET E VLERËSIMIT TË TREGUESVE

A. Pasqyrimi në mënyrë grafike i treguesve të marrë për vlerësim

Nga përpunimi i pyetësorëve janë marrë disa të dhëna të përgjithshme nga të cilat u vu re se grupmoshat e të anketuarëve që dominojnë për Bashkinë Tiranë janë 41-50 vjeç që përbëjnë 32% të totalit të ndjekur nga grupmosha 18-29 vjeç që përbëjnë 29.3% të të anketuarëve. Në bashkinë Cërrik grupmosha 18-29 vjeç përbën 38% dhe ajo 41-50 vjeç 27% të të anketuarëve. Përsa i përket punësimit në Bashkinë Tiranë 48% e të anketuarëve kanë pohuar se janë të punësuar dhe 21% të papunë. Në Bashkinë Cërrik 33.3% e të anketuarëve rezultuan të papunë dhe 23.3% të punësuar. Duke iu referuar gërmës (g) të kapitullit të metodologjisë treguesit janë vlerësuar për nga pesha e tyre (në % dhe numerikisht) që paraqitet e ilustruar me grafikët përkatës më poshtë:

a. Tregues të përfshirjes së qytetarit në procesin e hartimit të politikave dhe projekt-akteve lokale në Bashkinë Tiranë dhe Cërrik

Në nenin 6 pika 1 e ligjit"Për njoftimin dhe konsultimin publik"në lidhje me pjesëmarrjen qytetare parashikohet se: ***"Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik[29]".*** Gjithashtu në nenin[30]nr.16 pika 1 e ligjit "Për vetëqeverisjen vendore" në lidhje me sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarit në procesin e konsultimeve publike parashikohet se: ***"Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes".***

Të pyetur në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në procesin e konsultimeve publike të projekt-akteve lokale gjatë periudhës kohore 2015 – 2017, grupet e të anketuarëve për të dy bashkitë që janë përgjigjur pozitivisht pasqyrohet në grafikun nr.1 më poshtë:

Grafikunr.1: – Pjesëmarrja e qytetarit në procesin e konsultimit publik



[29] Neni 6 pika 1 i ligjit "Për njoftimin dhe konsultimin public" http://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/ligj_nr_146_per_njoftim_konsultim_publik_dt_30_10_2014_19918_1-2.pdf

[30] Ligji nr. 139/2015 "për vetqeverisjen vendore" neni 16 pika 1 http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/40-ligj-nr-1392015-date-17-12-2015-per-veteqeverisjen-vendore

Siç shihet në grafikun më sipër pjesëmarrja më e lartë është për OJF-të dhe qytetarët e anketuar në Bashkinë Cërrik përkatësisht 100% dhe 33%, ndërsa në Bashkinë Tiranë për OJF-të e anketuara me 27%. Nga grafiku vihet re gjithashtu përqindje *shumë e ulët* dhe *e ulët* e shkallës së pjesëmarrjes së biznesit dhe qytetarëve të anketuar në Bashkinë Tiranë me 18% dhe 23%. Një nga arsyet e shkallës së ulët të pjesëmarrjes është interesi dhe ndërgjegjësimi i ulët i qytetarëve për rolin e tyre në vendimmarrje. Qytetarët gjithashtu gjatë takimeve në komunitet u shprehën se nuk janë lajmëruar nga administrata e qeverisjes vendore dhe për këtë arësye nuk kanë marrë pjesë në konsultimet e dëgjesat publike. Nga përpunimi i intervistave të realizuara me staf të administratës publike të qeverisjes vendore në Bashkinë Tiranë pjesëmarrja qytetare për 24.3 % të të intervistuarëve është vlerësuar *e ulët* dhe për 46.3% e e tyre *e mjaftueshme*. Në Bashkinë Cërrik pjesëmarrja qytetare është vlerësuar *e mjaftueshme* për 55% të administratës vendore të intervistuar.

Në nenin 20 pika 1 gërma c e ligjit "Për njoftimin dhe konsultimin publik" në lidhje me rekomandimet dhe transparencën e procesit të konsultimit publik që ka të bëjë me pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje parashikohet se: ***"[31]Organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes,*** k***u përfshihet informacion për numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuara dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes"***

Të pyetur nëse janë në dijeni për marrjen parasysh të komenteve dhe rekomandimeve të tyre gjatë procesit të konsultimeve publike lokale grupet e të anketuarëve që janë përgjigjur pozitivisht paraqitet grafikisht si më poshtë:

Grafiku nr.2: – Mendimi qytetar për marrjen parasysh të rekomandimeve nga qeverisja vendore



Nga grafiku nr.2 më sipër shihet se përqindja e të anketuarëve që janë përgjigjur pozitivisht në lidhje me dijeninë e tyre për marrjen parasysh të rekomandimeve nga qeverisja vendore është mjaft e ulët nga 7 – 27%. Vihet re vlera 0% për OJF-të në Bashkinë Cërrik për këtë tregues.

[31] Ligji "për njoftimin dhe konsultimin publik", neni 20 pika 1 gërma (c) 2 http://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/ligj_nr_146_per_njoftim_konsultim_publik_dt_30_10_2014_19918_1-2.pdf

Përgjigjet pozitive të biznesit të anketuar në këtë bashki përbëjnë 10% të totalit të tyre. Në bashkinë Tiranë vlerat më të ulta të këtij treguesi janë për target grupin e OJF-ve të anketuara me 7%. Në këtë bashki, ndonëse për këtë tregues paraqitet pak më mirë se Bashkia Cërrik, edhe vlerësimi për qytetarët është *shumë i ulët* pasi vetëm 19% e tyre kanë dhënë përgjigje pozitive. Këto përqindje të ulta lidhen me faktin që qytetarët nuk janë vënë në dijeni sa duhet nga organet publike (bashkitë) për marrjen në konsideratë të rekomandimeve të tyre për shkak se nuk janë bërë publike[32]nëpërmjet mekanizmave të përcaktuara me ligj[33] por edhe për shkak të aksesit të tyre të ulët në faqet zyrtare të bashkive e sidomos të grupeve vulnerabile. Vlen të përmendim në këtë rast faktin që në Bashkinë Cërrik nuk ka një program transparence të bërë publik.

b. Tregues të Informimimit publik

Ligji "Për informimin publik" nuk ka qëllim vetëm të garantoj të drejtën e çdo individi të kërkoj informacion, por është edhe një instrument që e bën qeverisjen më të mirë dhe shtetin më të drejtë.
Në nenin 15 pika 1dhe 2 e ligjit "Për informimin publik" në lidhje respektimin e afateve të kthimit të përgjigjeve të kërkesave për informacion parashikohet se:***"Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe"***[34]
"Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë"
Nga përpunimi i pyetësorëve dhe intervistave në lidhje me respektimin e afateve të kthimit të përgjigjeve nga ana e administratës së qeverisjes vendore për sa i përket kërkesave për informacion të qytetarëve gjatë periudhës kohore 2015 – 2017, mendimi i target grupeve të anketuara paraqitet në grafikët nr.3 dhe 4 më poshtë:

Grafiku nr.3 -Mendimi qytetar për trajtimin e kërkesave për informacionin në Bashkinë Tiranë



[32] Raportet vjetore për transparencën neni 20 pika 1 gërma c l ligjit "Për njoftimin e konsultimin publik'
[33] Ligji "për njoftimin dhe konsultimin publik" neni 11 pika 1 dhe 2 https://www.akep.al/images/stories/AKEP/legjislacioni/LIGJ-Nr146-2014-010515.pdf
[34] Ligji "për informimin publik", neni 15 pika 1 dhe 2 www.dap.gov.al

Grafiku nr.4- Mendimi qytetar për trajtimin e kërkesave për informacionin në Bashkinë Cërrik



Nga grafikët 3 dhe 4 shihet që për Bashkinë Tiranë përqindjet më të larta të përgjigjeve pozitive nga të anketuarit janë dhënë për respektimin e *afatit 10 ditor* (27% qytetari, 26 % biznesi dhe 13% OJF-t) ndërsa afatet e tjera *10-15* dhe *mbi 15 ditë* zënë një përqindje që vjen duke u ulur. Për Bashkinë Cërrik përgjigjet pozitive nga të anketuarit për respektimin e afatit *10 ditor* nga ana e administratës janë (27% qytetari, 20% biznesi dhe 50% OJF-t). Për aftatet e tjera vlerat e përgjigjeve pozitive paraqiten me ulje e ngritje por gjithmonë nën vlerat e përqindjeve të afatit *10 ditor*. Përgjigjet e target grupit të OJF-ve të anketuara në këtë bashki në të treja afatet është 50%. Ajo që përbën interes është rasti i moskthimit të përgjigjes fare nga administrata i kërkesave për informacion që për bashkinë Tiranë rezulton se 7% e qytetarëve, 2% e biznesit dhe 13% e OJF-ve të anketuara kanë pohuar që nuk kanë marrë përgjigje për kërkesat e tyre. Në Bashkinë Cërrik vetëm 8% e qytetarëve të anketuar kanë pohuar të njëjtën gjë.

Në grafikun nr.5 më poshtë paraqitet nr. i kërkesave për informacion të qytetarëve të refuzuara dhe *që nuk u është kthyer* përgjigje fare nga administrata.

Grafiku nr. 5 – Trajtimi i kërkesave për informacion nga administrata publike e qeverisjes vendore



Grafiku më sipër përforcon më shumë përgjigjet e qytetarëve për mënyrën e trajtimin të kërkesave për informacion nga administrata e qeverisjes vendore duke paraqitur numerikisht kërkesat e refuzuara dhe që nuk u është kthyer përgjigje. Nga përgjigjet pohuese të të anketuarëve rezulton që në total numri i *kërkesave të* refuzuara është 42 nga të cilat 36 në Bashkinë Tiranë dhe 6 në Bashkinë Cërrik. Nga kërkesat e refuzuara 38 janë të qytetarëve të anketuar në të dy bashkitë nga të cilat 35 në Bashkinë Tiranë dhe 3 në Bashkinë Cërrik. Kërkesat që nuk u është kthyer fare *përgjigje* sipas të anketuarëve rezultojnë gjithësej 66 nga të cilat 61 në Bashkinë Tiranë dhe 5 në Bashkinë Cërrik. Përsëri nga *kër*kesat *që nuk i është kthyer përgjigje* 57 janë të qytetarëve të anketuar në të dy bashkitë nga të cilat 53 në Bashkinë Tiranë dhe 4 në Bashkinë Cërrik.

Të pyetur në lidhje me ankimimet në rast të refuzimit të kërkesave ose moskthimit të përgjigjeve nga administrata 12% e të anketuarëve të biznesit në Bashkinë Tiranë kanë dhënë përgjigje pozitive për ankimimet dhe nga këta 9.5% ia kanë drejtuar ankesat bashkisë dhe 2.5% e tyre Komisionerit për Informimin Publik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KIPMDP). Në Bashkinë Cërrik 10 % e të anketuarëve të biznesit kanë bërë ankimime të cilat ia kanë drejtuar bashkisë dhe (KIMDP). Përsa i përket ankesave nga qytetari për Bashkinë Tiranë rezultojnë 22 ankesa të refuzuara dhe 11 që nuk u është kthyer përgjigje fare. Në Bashkinë Cërrik rezultojnë 3 ankesa të refuzara dhe 9 që nuk është marrë përgjigje fare nga administrata. Qytetarët për ankesat e tyre nuk i janë drejtuar institucioneve të përmendura më sipër (Bashkisë përkatëse ose KIMDP).

Grafiku nr.6 – Mendimi i qytetarëve për informacionin që ofron administrata publike vendore



Nga grafiku më sipër vihet re përqindje e ulët (13.3 – 27.2%) e të anketuarëve të të dy bashkive që janë përgjigjur pozitivisht për informacionin që ofron administrata për informimin publik të komunitetit. Kjo përqindje e ulët është përballë me përqindjen e përgjigjegjeve pozitive të të intervistuarëve të administratës publike të qeverisjes vendore të dy bashkive (64% dhe 70.5%). Ajo që vihet re në grafik është që përqindjet e përgjigjeve pozitive të të anketuarëve të Bashkisë Tiranë janë më të larta se ato të Bashkisë Cërrik duke bërë përjashtim biznesi.

c. Treguesit e ofrimit të shërbimeve

Grafikët nr.7 dhe 8 më poshtë pasqyrojnë në mënyrë të ilustruar dy tregues që kanë të bëjnë me mendimin e qytetarëve për mekanizmat e përdorur nga administrata për sigurimin e cilësisë së

shërbimeve të ofruara. Këto mekanizma janë anketimet për cilësinë e shërbimeve dhe studimet e nevojave të komunitetit në mënyrë që ofrimi i shërbimeve të jetë në përputhje me nevojat reale të përdoruesve të shërbimeve. Nga takimet në komunitet rezultoi që pjesëmarrësit nuk kishin dijeni dhe nuk ishin bërë pjesë e anketimeve të realizuara nga administrata në lidhje me shërbimet por nuk kishin dijeni gjithashtu as nëse shërbimet e ofruara ishin të bazuar në studime të nevojave. Nga përpunimi i pyetësorëve përgjigjet pozitive të target grupeve të anketuara, të paraqitura në graf. nr.7, rezultojnë 33% e qytetarëve, 29% e biznesit dhe 20% e OJF-ve të anketuara për Bashkinë Tiranë dhe 18% e qytetarëve, 20% e biznesit e 50% e OJF-ve të anketuara për Bashkinë Cërrik. Sipas stafit të administratës së intervistuar në Bashkinë Tiranë Zyra e infomacionit dhe komunikimit me qytetarët ka realizuar në Shtator 2015 sondazh me qytetarët për cilësinë e shërbimit të ofruar në sportelet e informimit duke përdorur pyetësorë të thjeshtë e të shkurtër (me 9 pyetje). Sondazhi është bërë publik në faqen zyrtare të bashkisë[35]. Në këtë bashki janë realizuar anketime online në faqen zyrtare[36] për marrjen e mendimit qytetar në lidhje me shërbimin e çerdheve publike. Pavarësisht kësaj shkalla e njohjes nga ana e qytetarit si nga takimet e realizuara dhe nga pyetësorët përsa i përket anketimeve për shërbimet rezulton *shumë e ulët* dhe *e ulët* për të anketuarit në Bashkinë Tiranë. Edhe në Bashkinë Cërrik gjithashtu, me përjashtim të OJF-ve të anketuara që kanë dhënë përgjigje pozitive 50% e tyre.

Graf.nr.7 – Dijenia për mekanizmin e marrjes së mendimit qytetar që siguron cilësinë e shërbimeve



[35] Faqja zyrtare e Bashkisë Tiranë http://www.tirana.al/publikimepdf/Sondzh%20mbi%20sherbimin%20ne%20Sektorin%20e%20Pritjes%20dhe%20Komunikimit%20me%20Qytetaret.pdf

[36] http://tirana.gov.al/

Graf. nr. 8 – Mendimi qytetar për ofrimin e shërbimeve bazuar në studim të nevojave



Të pyetur për sigurimin nga administrata e qeverisjes e vendore të qasjes në shërbime të grupeve vulnerable, në përputhje me nevojat e tyre, qytetarët dhe OJF-të e anketuara në Bashkinë Tiranë që kanë dhënë pëgjigje pozitive përbëjnë përkatësisht 21% dhe 13.3% të totalit të tyre. Pra bëhet fjalë për një përqindje shumë të ulët. Grafikisht kjo paraqitet në grafikun nr.9 më poshtë.

Grafiku nr.9 – Mendimi qytetar për sigurimin e qasjes në shërbime të grupeve vulnerabile



Nga grafiku më sipër shihet që për Bashkinë Cërrik 43% e qytetarëve dhe 100% e OJF-ve të anketuara mendojnë se administrata e qeverisjes vendore siguron qasje në shërbime për grupet vulnerable në përputhje me nevojat e tyre. Duket qartë që përqindja e të anketuarëve që kanë dhënë përgjigje pozitive për këtë tregues është më e lartë në Bashkinë Cërrik. Përqindja e të intervistuarëve të administratës që kanë dhënë përgjigje positive si gjithmonë edhe në këtë rast është e lartë për të dy bashkitë (82 dhe 85%).

Grafiku nr.10 – Mendimi qytetar për kanalet zgjedhëse të ofrimit të shërbimeve nga administrata e qeverisjes vendore (BashkiaTiranë)



Grafiku nr.11 – Mendimi qytetar për kanalet zgjedhëse të ofrimit të shërbimeve nga administrata e qeverisjes vendore (Bashkia Cërrik)



Grafikët nr.10 dhe 11 më sipër pasqyrojnë qartë që për 43% të qytetarëve të anketuar në të dy bashkitë *kërkesat* janë forma më e përdorshme dhe efektive për marrjen e shërbimit të ofruar nga administrata vendore. Për target grupin e biznesit 55% e të anketuarve në Bashkinë Tiranë përdorin më shumë *faqen zyrtare të bashkisë* ndërsa në Bashkinë Cërrik 40 % e biznesit të anketuar përdor

më shumë *kërkesat* për marrjen e shërbimit. 47% e OJF-ve në Bashkinë Tiranë përdorin më shumë *faqen zyrtare të bashkisë* ndërsa në Bashkinë Cërrik 100% e OJF-ve përdorin më shumë *kërkesat.* Përsa i përket përgjigjeve të stafit të administratës për 68% të të intervistuarve në Bashkinë Tiranë janë *kërkesat* forma më e njohur dhe e përdorshme për marrjen e shërbimit ndërsa për 73% të të intervistuarëve të administrates në Bashkinë Cërrik është *faqja zyrtare e bashkisë*. *E-shërbimet* është një kanal i ofrimit të shërbimeve pak i njohur dhe i përdorur nga të tre target grupet e anketuara të bashkive pilot përqindjet e përgjigjeve positive të të cilëve janë në kufirin 0-20%.

B. Tabelat përmbledhëse të vlerësimit të treguesve me pikë (1-5)

Procesi i vlerësimit të mendimit qytetar për administratën publike të qeverisjes vendore u arrit nëpërmjet realizimit pararelisht të pyetësorëve për komunitetin dhe intervistave për stafin e administratës. Çështjet e trajtuara në rubrikat e pyetësorëve ishin të ngjashme me ato të intervistave si dhe me ato që u trajtuan gjatë takimeve në komunitet. Kjo ndihmoi që të merrej informacion për të njëjtin tregues të marrë në analizë si nga komuniteti edhe nga administrata publike e qeverisjes vendore. Siç është përcaktuar në gërmën (g) të kapitullit të metodologjisë, treguesit janë vlerësuar edhe nga vetë qytetarët dhe administrata sipas sistemit të pikëzimit 1-5 (1 është vlerësimi më i ulët dhe 5 më i lartë). Në tabelat më poshtë paraqitet vlerësimi në bllok i treguesve të marrë në analizë për secilën çështje:

<u>Treguesit e përfshirjes së qytetarit në procesin e hartimit të politikave dhe projekt-akteve lokale:</u>

Treguesit më poshtë janë vlerësuar me pikë në bllok nga 85% e qytetarëve, 75% e biznesit, 58% e OJF-ve të anketuara dhe 92.3% e administratës së intervistuar në Bashkinë Tiranë si dhe nga 97.4% e qytetarëve, 100% e biznesit, 100% e OJF-ve e 100% e administratës në Bashkinë Cërrik.

- Pjesëmarrja e qytetarit në procesin e konsultimeve publike të projekt-akteve lokale
- Marrja në konsideratë nga qeverisja e komenteve / rekomandimeve të qytetarit gjatë procesit të konsultimit publik
- Ofrimi i informacionit të mjaftueshëm nga qeverisja për çështjet gjatë procesit të konsultimit publik

Nga përpunimi i tabelave të pikëzimit, që ishin pjesë e pyetësorëve dhe intervistave, treguesit e përfshirjes së qytetarit në procesin e vendimmarrjes për të dy bashkitë sipas zonave të shtrirjes së njësive administrative pilot paraqiten të vlerësuar me pikë (1-5) në tabelën nr.1 më poshtë.

Tabela nr.1 – Vlerësimi i treguesve të përfshirjes së qytetarit në procesin e hartimit të politikave e projekt-akteve lokale

Njësitë administrative sipas zonave	Bashkia Tiranë				Bashkia Cërrik			
	Qytetari	Biznesi	OJF-t	Administrata	Qytetari	Biznesi	OJF-t	Administrata
Njësitë Administrative urbane	2.2	2.3	2.3	3.8	2.3	1.8	2.5	5
Njësitë Administrative rurale	2.8	4.2		4.2	3.1			3.1

Nga tabela nr.1 më sipër vihet re se vlerat më të larta (në pikë) të treguesve në bllok që kanë të bëjnë me përfshirjen qytetare në vendimmarrje janë dhënë nga të anketuarit në NjA-t rurale të dy bashkive në kufijtë (2.8 – 4.2 pikë). Përsa i përket vlerësimit të administratës në Bashkinë Cërrik është më i lartë (5 pikë – *shumë i lartë*) për të intervistuarit e administratës së NjA-s urbane ose më saktë për NjA-n Cërrik. Po nga tabela shihet që vlerësimi më i ulët është dhënë nga biznesi (1.8 pikë – *shumë i ulët*) i anketuar në NjA-n urbane[37] të Bashkisë Cërrik dhe nga qytetarët e anketuar të NjA-ve urbane të Bashkisë Tiranë (2.2 pikë – nivel *i ulët*). Pra qytetarët në Bashkinë Tiranë dhe biznesi në Bashkinë Cërrik të anketuar në NjA.-t urbane kanë bërë vlerësim *shumë të ulët* dhe *të ulët* të treguesve të mësipërm. E njëjta gjë vërehet pak a shumë edhe për vlerësimin e këtyre treguesve nga OJF-të për NjA-t urbane të Bashkisë Tiranë dhe Cërrik përkatësisht (2.3 dhe 2 .5 pikë – nivel *i ulët*). Kuadratet e paplotësuara në tabelë kanë të bëjnë me faktin se në Bashkinë Cërrik bizneset dhe OJF-të e anketuara ushtrojnë aktivitetin e tyre në NjA. Cërrik që i përket zonës urbane dhe në Bashkinë Tiranë OJF-të e anketuara ushtrojnë aktivitetin e tyre në NjA-t pilote nr.5 dhe 6 që i përkasin zonës urbane.

Treguesit për informimin publik:

Treguesit më poshtë janë vlerësuar me pikë në bllok nga 83% e qytetarëve, 75.4% e biznesit, 55.5% e OJF-ve të anketuara dhe 87% e administratës së intervistuar në Bashkinë Tiranë si dhe nga 97% e qytetarëve, 100% e biznesit, 100% e OJF-ve e 85% e administratës së intervistuar në Bashkinë Cërrik

- Informacioni i rregjistruar dhe i dokumentuar nga qeverisja është i mjaftueshëm për akses në informimin publik
- Informacioni i kërkuar ofrohet sipas afateve të përcaktuara me ligj.
- Informacioni ofrohet pa pagesë

Në Kushtetutën[38] e Shqipërisë neni 23, pika 1 thuhet; ***"E drejta e informimit është e garantuar "*** ndërsa në[39]nenin 19 pika 2 e ligjit nr.139/2015 "për vetqeverisjen vendore" në lidhje me trajtimin e kërkesave dhe ankesave parashikohet se: ***"Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërrejtjet dhe të kthejnë përgjigje brënda afateve të përcaktuara me ligj"***

Vlerësimi me pikë i treguesve të informimit publik në bllok nga të anketuarit dhe të intervistuarit pasqyrohet në tabelën nr.2 më poshtë. Nga tabela vihet re sërish që vlerësim të lartë i treguesve është bërë nga të anketuarit e njësive administrative të zonave rurale krahasuar me ato urbane. Ky rezultat përbën edhe një nga gjetjet e projektit. Ndërsa sipas grupeve të anketuara vlerësim më të lartë për Bashkinë Tiranë ka dhënë biznesi me 4.6 pikë kurse për Bashkinë Cërrik qytetari me 3.4 pikë. Vlerësimi i administratës së të dyjave bashkive është në vlerat e 3.3 - 4.6 pikë. Kuadratet e paplotësuara në tabelën nr.2 shpjegohen njësoj si për tabelën nr. 1 më sipër.

[37] Biznesi i anketuar është vetëm për NjA-n urbane Cërrik të Bashkisë Cërrik
[38] Kushtetuta e Shqipërisë 2016, nenei 23 pika 1 http://www.pp.gov.al/web/kushtetuta_2016_1082.pdf
[39] Ligji nr. 139/2015 "për vetqeverisjen vendore" neni 19 pika 2 http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/40-ligj-nr-1392015-date-17-12-2015-per-veteqeverisjen-vendore

Tabela nr.2 – Vlerësimi i treguesve të informimit publik

	Bashkia Tiranë				Bashkia Cërrik			
Njësitë administrative sipas zonave	**Qytetari**	**Biznesi**	**OJF-t**	**Administrata**	**Qytetari**	**Biznesi**	**OJF-t**	**Administrata**
Njësitë Administrative urbane	2.5	3	2.8	4.2	2.8	2.8	3.5	4.5
Njësitë Administrative rurale	3.4	4.6		4.6	3.4			3.3

Një tregues tjetër në drejtim të informimit publik që ja vlen të shihet më vehte është edhe vlerësimi me pikë (1-5) i qytetarit për burimet më efektive të ofrimit të informacionit nga administrata e qeverisjes vendore që paraqitet në tabelën nr. 3 më poshtë.

Tabela nr. 3 – Vlerësimi nga qytetarët i burimeve më efektive të ofrimit të informacionit

Vlerësimi sipas sistemit me pikë 1-5		
Burimet e informacionit të vlerësuara më efektive	**Bashkia Tiranë**	**Bashkia Cërrik**
Zyrat e administratës	3	3.3
Faqja zyrtare e bashkisë/NjA-ve	2.6	2.4
Njoftimet në ambjentet e bashkisë dhe NjA-ve	2.8	3
Zyra e informacionit në bashki	2.9	3.1
Total	**2.8**	**2.9**

Nga tabela më sipër vihet re dukshëm që burimi i informimit më efektiv i vlerësuar me më shumë pikë (3 dhe 3.3 pikë – nivel *i kënaqshëm*) për qytetarët e anketuar në të dy bashkitë janë *zyrat* e administratës ndërsa burimi i informacionit i vlerësuar me më pak pikë (2.4 dhe 2.6 pikë – nivel *i ulët*) janë *faqet zyrtare të bashkive dhe NjA-ve pilot*. Pra siç shihet qytetarët, ndër burimet e ofrimit të informacionit nga administrata, konsiderojnë ende më efektive *zyrat e administratës* dhe kanë më pak qasje ose akses ndaj formave *proaktive* të ofrimit të informacionit nga bashkitë.

Treguesit e Ofrimit të shërbimeve: - Mekanizmat që sigurojnë cilësinë

Treguesit më poshtë janë vlerësuar me pikë në bllok nga 85.2% e qytetarëve, 75% e biznesit, 53.3% e OJF-ve të anketuara dhe 68.5% e administratës së intervistuar në Bashkinë Tiranë si dhe nga 98.4% e qytetarëve, 100% e biznesit, 100% e OJF-ve e 100% e administratës së intervistuar në Bashkinë Cërrik

- Informimi për mekanizmin e marrjes së mendimit qytetar të përdorur nga administrata në lidhje me cilësinë e shërbimeve të ofruara;
- Rishikimi dhe ridizenjimi i shërbimeve të ofruara nga qeverisja ka ardhur si rezultat i monitorimit dhe vlerësimit të qytetarëve;

Tabela nr.4 – Vlerësimi i treguesve të mekanizmave që sigurojnë cilësinë e shërbimeve[40]

Njësitë administrative sipas zonave	Bashkia Tiranë				Bashkia Cërrik			
	Qytetari	Biznesi	OJF-t	Administrata	Qytetari	Biznesi	OJF-t	Administrata
Njësitë Administrative urbane	2.3	2.5	2	3.2	2.5	1.8	1.7	2.6
Njësitë Administrative rurale	2.6	3.9		4.4	2.9			2

Duke e parë me një sy analitik tabelën nr.4 më sipër, vëmë re sërish vlerësimet me pikë më të larta nga të anketuarit në NjA-t pilot të shtrira në zonat rurale të dy bashkive përsa i përket treguesve të ofrimit të shërbimeve që kanë të bëjnë me mekanizmat që përdor administrata për sigurimin e cilësisë së shërbimeve. Po ta shikojmë këtë vlerësim sipas grupeve të anketuara për Bashkinë Tiranë rezulton që vlerësim më të lartë ka dhënë biznesi me 3.9 pikë që i korrespondon nivelit *të mirë* dhe në Bashkinë Cërrik qytetari me 2.9 pikë që i përket nivelit *të kënaqshëm*. Vlerësim më i ulët i treguesve të mësipërm prej 1.7 pikësh (nivel *shumë i ulët*) është dhënë nga OJF-të që veprojnë në zonën urbane të Bashkisë Cërrik.

Treguesit e ofrimit të shërbimeve: - Sigurimi i qasjes në shërbime

Treguesit më poshtë janë vlerësuar me pikë në bllok nga 80% e qytetarëve, 84.5% e biznesit, 60% e OJF-ve të anketuara dhe 88.6% e administratës së intervistuar në Bashkinë Tiranë si dhe nga 95% e qytetarëve, 100% e biznesit, 100% e OJF-ve e 97% e administratës së intervistuar në Bashkinë Cërrik

- Sigurimi i qasjes në shërbime të grupeve vulnerable në përputhje me nevojat e tyre individuale
- Sigurimi nga ana e administratës së qeverisjes të kanaleve të ndryshme zgjedhëse në ofrimin e shërbimeve
- Ngritja dhe funksionimi nga bashkia i one-stop shop-ve të aksesueshme për të gjithë

Tabela nr. 5 - Vlerësimi i treguesve të sigurimit të qasjes në shërbime[41]

Njësitë administrative sipas zonave	Bashkia Tiranë				Bashkia Cërrik			
	Qytetari	Biznesi	OJF-t	Administrata	Qytetari	Biznesi	OJF-t	Administrata
Njësitë Administrative urbane	2.2	2.8	1.7	3.6	2.5	2.4	2.5	3.5
Njësitë Administrative rurale	3	1		3.8	3.1			2.5

Nga tabela më sipër vërehet që për treguesit në bllok që garantojnë qasjen në shërbime në Bashkinë Tiranë, vlerësimet më të ulta janë dhënë nga bizneset e anketuara që ushtrojnë aktivitet në NjA-t rurale me (1 pikë) dhe nga OJF-të e anketuara me (1.7 pikë). Këto vlerësime

[40] Kuadratet e paplotësuara në tab. nr.4 kanë të bëjnë me faktin se në Bashkinë Cërrik bizneset dhe OJF-të e anketuara i përkasin zonës urbane dhe në Bashkinë Tiranë OJF-të e anketuara i përkasin zonës urbane

[41] Kuadratet e paplotësuara në tab. nr.5 kanë të bëjnë me faktin se në Bashkinë Cërrik bizneset dhe OJF-të e anketuara i përkasin zonës urbane dhe në Bashkinë Tiranë OJF-të e anketuara i përkasin zonës urbane.

përkojnë me nivelin *shumë i ulët*. Treguesit e mësipërm qytetarët e anketuar në NjA-t rurale të të dy bashkive i kanë vlerësuar në nivelin e *kënaqshëm* (me 3 dhe 3.1 pikë). Vlerësim me pikë më shumë kanë dhënë të intervistuarit e administratës në NjA-t rurale dhe urbane të Bashkisë Tiranë përkatësisht me (3.8 dhe 3.6 pikë).

Tabela nr.6 – Vlerësimi i kënaqësisë së qytetarit për shërbimet e ofruara në bashkitë pilot

Shërbimet publike dhe administrative të vlerësuara nga komuniteti	**Vlerësimi me pikë 1-5**					
	Bashkia Tiranë			**Bashkia Cërrik**		
	Qytetari	Biznesi	OJF-t	Qytetari	Biznesi	OJF-t
Çerdhet publike	2.9	-	2.2	1	-	2
Kopshtet publike	3	-	2.2	3.5	-	3
Mbrojtja sociale	2.7	-	1.8	2.6	-	3
Gjendja civile	3.2	-	3.8	3.5	-	4
Trajtimi i kërkesave për dhënie leje të ndryshme	2.3	3.6	1.8	3.2	2.6	3

Në nenet 23 pika 12 dhe 24 pika 1 të ligjit "Për vetëqeverisjen vendore" përsa i përket funksioneve të bashkive në lidhje me shërbimet publike dhe sociale parashikohet se: ***"Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale në nivel vendor..."***, dhe ***"Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe".***

Duke iu referuar tabelës nr.6 më sipër ku vlerësohet me pikë kënaqësia për shërbimet e ofruara nga administrata, vihet re që shërbimi i gjendjes civile është vlerësuar me më shumë pikë në të dy bashkitë (nga 3.2 – 4 pikë). Shërbimi i vlerësuar me më pak pikë është shërbimi i çerdheve publike që lëviz në kufijtë (1 – 2.9 pikë). Ky vlerësim i fundit përputhet edhe me shprehjen e mendimit të qytetarit gjatë takimeve në komunitet por edhe nga intervistat me administratën publike të qeverisjes vendore për mungesën e këtij shërbimi në Bashkinë Cërrik dhe në NjA-t rurale të Bashkisë Tiranë si dhe mosplotësimin e nevojave të qytetarëve për këtë shërbim në zonat qytetare të kësaj bashkie.

VIII. GJETJET

A. Gjetjet për Bashkinë Tiranë

a. Përfshirja e qytetarit në procesin e hartimit të politikave dhe projekt-akteve lokale

Nga përpunimi i pyetësorëve të realizuara në NjA-t pilot (nr.5, 6, Dajt dhe Petrelë) të Bashkisë Tiranë rezultuan këto gjetje:

Gjetje sasiore :

- Pjesëmarrja e qytetarit në procesin e konsultimit publik, referuar periudhës kohore 2015 – 2017, rezultoi 23%, e biznesit 18% dhe e OJF-ve të anketuara 27%.
- Të pyetur në lidhje me mekanizmat e njoftimit për procesin e KP të projekt-akteve lokale 12.4% e qytetarëve të anketuar kanë vlerësuar si më të përdorshmet dhe efektive *njoftimet në mjediset e NjA-ve e bashkisë qëndrore.*
- Në lidhje me ofrimin e informacionit shoqërues nga administrata vendore për projekt-aktet lokale që kanë qënë çështje të diskutimeve publike janë përgjigjur pozitivisht 20% e qytetarëve, 24% e Biznesit dhe 47% e OJF-ve të anketuara.
- 38.1% e qytetarve, 41% e biznesit dhe 87% e OJF-ve kanë pohuar se janë në dijeni të ligjit "Për njoftimin dhe konsultimin publik".
- 17.2% e qytetarëve të anketuar kanë pohuar se kanë qënë pjesë e komisioneve qytetare gjatë procesit të KP[42] dhe nga 15 OJF-të e anketuara 3 prej tyre ose 20% kanë pohuar se bëjnë pjesë në komisionet qytetare të Bashkisë Tiranë.
- Nga anketimet rezultoi se 19% e qytetarëve, 26% e biznesit dhe 7% e OJF-ve mendojnë se rekomandimet/komentet e tyre gjatë procesit të konsultimit publik janë marrë në konsideratë nga qeverisja.

Gjetje cilësore:

- Gjatë takimeve rezultoi që qytetarët nuk kishin njohuri që mbledhjet e këshillit bashkiak[43] ishin të hapura dhe mund të merrnin pjesë.
- Konsultimi publik online, ndonëse ofrohet nga Bashkia Tiranë, në përgjithësi në të gjitha NjA-t pilot ku u zhvilluan takime rezultoi që nuk njihej dhe përdorej nga qytetarët.
- Nga takimet në komunitet rezultoi se qytetarët nuk ishin në dijeni të se drejtës së tyre, të përcaktuar me ligj[44], për të paraqitur inisiativa qytetare për vendimmarrje në Këshillin Bashkiak.
- Nga takimet me qytetarët e NjA-ve pilot rezuktoi gjithashtu se pjesëmarrja e të pranishmëve në procesin e konsultimit publik ishte e ulët.

[42] Konsultimi publik

[43] Neni 17 pika 1 e ligjit nr. 139/2015, http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/40-ligj-nr-1392015-date-17-12-2015-per-veteqeverisjen-vendore

[44] Neni nr.20 pika 1 dhe 2 i ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/40-ligj-nr-139/2015-date-17-12-2015-per-veteqeverisjen-vendore

Sipas administratës së Bashkisë Tiranë në drejtim të përfshirjes së qytetarit në vendimmarrje është punuar shumë dhe ende punohet si në drejtim të njoftimeve, formave të konsultimit publik dhe angazhimit të strukturave që ndihmojnë mobilizimin e komunitetit (ndërlidhësit e komunitetit dhe kryepleqtë). Në bashki funksionojnë 3 komisione të qytetarëve. Për vitin 2016 janë zhvilluar 100 dëgjesa publike për PPV dhe Buxhetin (nga një në çdo njësi administrative) me qytetarët e grupet e interesit si dhe 3 dëgjesa ligjore. Janë bërë publike njoftimet dhe kalendaret e takimeve për konsultime publike. Nga takimet me stafin e administratës së bashkisë dhe NjA-ve rezultoi gjithashtu se janë zbatuar vazhdimisht procedurat e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik siç janë përcaktuar në ligj dhe ekziston aksesi për konsultime publike online. Rekomandimet e qytetarit gjatë konsultimeve publike janë marrë në konsideratë në vendimmarrje. Gjatë periudhës Tetor – Nëntor 2016 nga Drejtoria e Informacionit dhe Komunikimit me Qytetarët është realizuar një sondazh në 24 njësitë administrative të Tiranës për pjesëmarrjen e qytetarit në procesin e konsultimit publik të PPV ku janë intervistuar 710 persona dhe në fund të sondazhit ka dalë që pjesëmarrja ishte 11%[45] ndërsa shkalla e njohjes së PPV ishte 48%.

Nga përpunimi i intervistave të realizuara me staf të administratës publike vendore pjesëmarrja qytetare për 24.3 % të anketuarëve u vlerësua *e ulët* dhe për 46.3% e e tyre *e mjaftueshme*. 82% e të intervistuarve të administratës kanë pohuar se rekomandimet/komentet e qytetarëve gjatë konsultimeve publike janë marrë në konsideratë nga qeverisja.

b. Informimi publik

Nga përpunimi i pyetësorëve rezultatet janë si më poshtë:

Gjetjet sasiore:

- Sipas shkallëzimit me pikë 1-5, burimet më efektive të marrjes së informacionit nga 71.6% e qytetarëve të anketuar në Bashkinë Tiranë janë vlerësuar *zyrat* (me 3 pikë), për 71% të tyre *shërbimi i informacionit në bashki* me (2.9 pikë) dhe për 69% e tyre janë vlerësuar *njoftimet në mjediset e bashkisë qëndrore dhe NjA-ve* me (2.8 pikë). Pra zyrat e administratës janë vlerësuar nga qytetari si burimi më efektiv për marrjen e informacionit ndërsa *faqja zyrtare e bashkisë dhe NjA-ve* është vlerësuar si burimi më pak efektiv për marrjen e informacionit me (2.6 pikë).

- 23.1% e qytetarëve, 27.2% e biznesit dhe 13.3% e OJF të anketuara e kanë konsideruar informacionin e regjistruar dhe të dokumentuar që ofron bashkia të mjaftueshëm për sigurimin e informimit publik të komunitetit.

- Në lidhje me pagesën[46] për marrjen e informacionit 54% e qytetarëve, 50% e biznesit dhe 33% e OJF-ve të anketuara në bashki kanë pohuar se nuk kanë paguar asnjëherë. Sipas zonave kjo përqindje në NjA-t urbane është 52.2% dhe ato rurale 61.5%.

- 41% e qytetarëve, 27% e biznesit dhe 13.3% e OJF-ve të anketuara janë shprehur se kanë njohuri për ligjin "Për të drejtën e informimin".

- 32% e qytetarëve të anketuar kanë pohuar se kanë dijeni për programin e transparencës së bashkisë.

Gjetje cilësore:

- Nga takimet me qytetarët si format më të përdorshme të informimit rezultuan *zyrat*

45 Sondazh për pjesmarrjen në konsultimet publike për PPV – faqja zyrtare e Bashkisë Tiranë www.tirana.gov.al

46 Neni nr.13 pika 1 dhe 2 i ligjit "Për të drejtën e informimit" - www.dap.gov.al

e administratës, më pak *njoftimet* në mjediset e NjA-ve ose bashkisë qëndrore si dhe *kërkesat* për informacion. Njohja e faqes zyrtare të web-it të bashkisë dhe facebook-u i njësive administrative rezultoi e ulët dhe në përgjithësi nuk përdorej.

- OJF-t në takim pohuan se kishin njohje të mirë të faqes zyrtare të bashkisë dhe përdornin aplikacionet e portalet e saj për marrje të informacionit statistikor.

- Nga kontaktet me biznesin një pjesë e tyre rezultoi që ka njohuri të pakta për ligjin "Për të drejtën e informimit", për informimin proaktiv që ofron bashkia dhe përdorin pak faqen e saj zyrtare dhe të institucioneve të varësisë (Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore).

- Në lidhje me kërkesat për informacion nga takimet në komunitet rezultoi se përgjigja e administratës qëndrore të bashkisë Tiranë në shumë raste nuk ka qënë sipas formatit të kërkuar, shpesh vinte me vonesë (1 muaj ose edhe më shumë e bile deri në një vit) ose nuk merrej përgjigje fare. Përgjigja e kërkesave për informacion nga administrata e NjA-ve, sipas qytetarëve, në përgjithësi ka respektuar afatin e përcaktuar me ligj (10-15 ditë) për periudhën kohore referuese 2015 - 2017.

- Në nenin[47] nr.15 pika 2 e ligjit nr.139/2015 në lidhje me transparencën e qeverisjes vendore parashikohet se ***"Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike".*** Nga takimet në NjA-t pilot nuk u konstatua afishim në mjediset e tyre të akteve të qeverisjes vendore.

Sipas administratës gjatë takimeve e intervistimeve por edhe nga konsultimi me faqen zyrtare rezultoi që informimi publik realizohet në mënyrë aktive e proaktive. Bashkia ka një faqe zyrtare web-i të strukturuar mirë dhe që ofron informacion të shumtë në drejtim të transparencës dhe të dhënave statistikore. Ajo ofron aplikacione (Tirana ime) dhe portale të dhënash (Open Data). VKB janë të publikuara në faqen zyrtare që prej vitit 1992. Legjislacioni dhe regjistri i kërkesave gjithashtu. Ky i fundit është edhe online. Nga verifikimi i rregjistrit[48] të kërkesave dhe përgjigjeve rezultoi se për periudhën Maj-Dhjetor 2016 janë rregjistruar 92 kërkesa nga të cilat 13 rezultojnë në trajtim dhe 79 janë zgjidhur. Kërkesat janë të gjitha pa pagesë dhe kthimi i përgjigjes është bërë brenda afatit të përcaktuar me ligj nga 10-15 ditë nga rregjistrimi i kërkesës. Për vitin 2017 gjatë periudhës Janar-Qershor janë rregjistruar 81 kërkesa të cilat janë të gjitha pa pagesë nga të cilat 13 rezultojnë në trajtim dhe 68 të zgjidhura. Afati i kthimit të përgjigjes edhe në këtë rast është bërë sipas ligjit për të gjitha kërkesat brënda 10-15 ditëve. NjA-t pilot kanë facebook por që kanë nevojë për përditësim të vazhdueshëm. Në bashki ka një koordinator për informimin publik emri dhe kontaktet e të cilit janë bërë publike në faqen zyrtare. Në NjA-t pilot përgjegjës për informimin publik janë specialistët e informimit. Kërkesat e qytetarit për informacion sipas administratës janë trajtuar sipas ligjit duke respektuar afatet përkatëse të kthimit të përgjigjes. Nga ana e koordinatorit për informimin publik, gjatë takimeve me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të administratës dhe qytetarëve, u shpjegua se rastet e vonesës në dhënien e përgjigjes ndodhin për faktin se është e detyrueshme respektimi i procedurës dhe i hierarkisë sipas drejtorive dhe titullarëve të tyre deri në zyrtarizimin e përgjigjes përfundimtare.

[47] http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/40-ligj-nr-1392015-date-17-12-2015-per-vete-qeverisjen-vendore

[48] Rregjistri i kërkesave dhe përgjigjeve të Bashkisë Tiranë, http://www.tirana.al/programi-transparences/regjistri-i-kerkesave/

c. Ofrimi i shërbimeve publike

Në drejtim të ofrimit të shërbimeve rezultuan këto gjetje:

Gjetje sasiore:

- Në lidhje me sigurimin e mekanizmave të përdorura nga administrata për garantimin e cilësisë 32.7% e qytetarëve të anketuar mendojnë se administrata e qeverisjes vendore i ofron shërbimet bazuar në studim të nevojave reale.

- 33% e qytetarëve të anketuar janë shprehur se e njohin mekanizmin e marrjes së mendimit qytetar (anketimet) për cilësinë e shërbimeve që ka përdorur administrata publike e qeverisjes vendore. Biznesi dhe OJF-të e anketuara kanë dhënë përgjigje pozitive për sa më sipër në masën 29% dhe 20%.

- Në lidhje me sigurimin e qasjes në shërbime të grupeve vulnerabile në përputhje me nevojat e tyre 21% e qytetarëve dhe 13.3% e OJF-ve anketuara mendojnë se administrata siguron qasjen e tyre në shërbime.

- Shërbimet më të vlerësuara nga qytetarët dhe OJF-të nga takimet por edhe nga vlerësimi me pikë (1-5) janë gjendja civile dhe aplikimet për ndihmën ekonomike (NE) e aftësinë e kufizuar (AK). Shërbimi më pak i vlerësuar është ai i çerdheve publike. Për biznesin është vlerësuar vetëm trajtimi i kërkesave për leje të ndryshme dhe marrje liçense.

- Në Bashkinë Tiranë efektiviteti i performancës së administratës publike nga 82.4% e qytetarëve të anketuar sipas sistemit të pikëzimit (1-5) është vlerësuar 2.8 pikë.

Gjetje cilësore:

- Komuniteti konfirmoi mungesën e shërbimit të çerdheve publike në NjA-t rurale pilot dhe mosplotësimin e nevojave në NjA-t urbane. Procedura e regjistrimit ka pasur raste problematike për shkak të numritdhe kapacitetit të kufizuar të çerdheve në Bashkinë Tiranë.

- Sipas komunitetit në shërbimin e kopshteve publike ka vend për përmirësim në drejtim të kushteve (ndërtesa, ngrohja e pajisja) dhe shtrirjes gjeografike sidomos për NjA-t rurale pilot. Përmendim rastin e zonës së Qesarakës në NjA-n Dajt që është e zbuluar nga shërbimet e mësipërme dhe në NjA-n Petrelë (fshati Gurë e madhe) ku kopshti publik është në gjendje shumë të keqe.

- Nga anketimet rezultoi se kanalet[49] më të përdorshme për marrjen e shërbimit për qytetarët janë *kërkesat* ndërsa për biznesin dhe OJF-të e anketuara është *faqja zyrtare e bashkisë.*

- Nga takimet në komunitet qytetari vlerësoi më shumë përsa i përket efektivitetit, profesionalizimit dhe etikës në punë shërbimin e ofruar nga administrata e NjA-ve se sa atë të administratës qëndrore të Bashkisë Tiranë.

- Shërbimi me shumë sportele (one-stop shop) në Bashkinë Tiranë funksionon në administratën qëndrore dhe në institucionet e varësisë kryesisht në drejtim të informimit. Në NjA-t urbane të kësaj bashkie ky shërbim është i pjesëshëm ndërsa në ato ruralet mungon.

- Shërbimi i dhënies së lejeve dhe liçensave lë për të dëshiruar. Në NjA-n Petrelë dhënia e

[49] Grafiku nr.10

lejeve për punime është bllokuar nga institucionet vartëse të Bashkisë Tiranë që prej një viti. Në NjA-n Dajt nga takimet me qytetarët rezultoi se ky shërbim ofrohet me vonesë dhe nuk plotëson në kohë nevojat imediate të banorëve.

- Aksesi fizik i personave me (AK) nuk është i siguruar në NjA-t rurale pilot të Bashkisë Tiranë.

B. Gjetjet për Bashkinë Cërrik

Bashkia Cërrik me ndarjen e re administrative ka përpara saj një sërë sfidash që kanë të bëjnë ndër të tjera me funskionimin e administratës në përgjigje të nevojave të qytetarëve, ngritjen e kapaciteteve të saj dhe futjen e teknollogjisë së re në fushën e ofrimit të shërbimeve, njoftimit dhe informimit publik. Ajo aktualisht po përballet edhe me mangësitë në buxhet dhe organikën e vogël. Nga përpunimi dhe analiza e pyetësorëve dhe intervistave rezultuan gjetjet si më poshtë:

a. Përfshirja e qytetarit në procesin e hartimit të politikave dhe projekt-akteve lokale

Gjetjet sasiore:

- Në lidhje me mekanizmat e njoftimit për procesin e konsultimit publik të projekt-akteve lokale në Bashkinë Cërrik 20% e qytetarëve të anketuar kanë vlerësuar *faqen zyrtare të bashkisë*.
- 33% e qytetarit, 30% e biznesit dhe 100% e OJF-ve të anketuar kanë pohuar se kanë marrë pjesë të paktën 1 herë në procesin e konsultimit publik të projekt-akteve lokale.
- Në lidhje me ofrimin nga administrata të informacionit shoqërues për projekt-aktet lokale vendore gjatë procesit të konsultimit publik 28.3% e qytetarëve dhe 80% e biznesit të anketuar janë përgjigjur pozitivisht ndërsa 100% e OJF-ve të anketuara janë përgjigjur negativisht.
- 11.6% e qytetarëve të anketuar kanë pohuar se kanë marrë pjesë në komisionet qytetare.
- 27% e qytetarëve dhe 20% e biznesit janë shprehur se proceset e konsultimit publik të projekt-akteve lokale dhe mekanizmat e përdorur janë respektuar vazhdimisht nga qeverisja vendore ndërsa 100% e OJF-ve të anketuara janë përgjigjur negativisht.
- 27% e qytetarit dhe 10% e biznesit të anketuar mendojnë se rekomandimet/ komentet e tyre gjatë procesit të konsultimit publik *janë marrë parasysh* nga qeverisja vendore ndërsa 100% e OJF-ve të anketuara janë përgjigjur *se nuk janë në dijeni*.

Gjetjet cilësore:

- Nga takimet në komunitet rezultoi se dijenia e qytetarëve për dokumentat kryesore si PPV dhe Buxhetin ishte e ulët.
- Edhe në këtë bashki qytetarët nuk ishin në dijeni se mbledhjet e Këshillit Bashkiak ishin të hapura dhe mund të merrnin pjesë në to.
- Nga takimet në komunitet rezultoi se qytetarët nuk ishin në dijeni të se drejtës së

tyre, të përcaktuar me ligj[50], për të paraqitur inisiativa qytetare për vendimmarrje në Këshillin Bashkiak.

- Konsultimi publik online nuk rezultoi i disponueshëm për qytetarët nga organi publik vendor.

- Në lidhje me njoftimin e qytetarëve në procesin e konsultimit publik, administrata publike vendore përveç formave të tjera të përcaktuara me ligj[51], praktikonte edhe metodën *derë më derë* të cilën e përdorte edhe për informimin publik. Kjo praktikë është e përshtatshme për bashki të vogla në territor dhe popullsi.

a. Informimi publik

Në Bashkinë Cërrik dhe NjAt-pilot nga takimet me stafin e administratës dhe shqyrtimi i faqeve zyrtare rezultoi se VKB-t nuk janë bërë publike në faqen zyrtare të bashkisë gjithashtu as programi i transparencës. Këto vendime duke filluar nga viti 2015 janë bërë publike në platformën online të VKB-ve, vendime.al[52]. Kjo bashki aktualisht ka një faqe facebook-u që nuk ofron shumë informacion dhe lë shumë për të dëshiruar në drejtim të përditësimit të saj. Për momentin bashkia në përputhje me ligjin "Për informimin publik" është duke ndërtuar faqen e web-it. Legjislacioni dhe regjistri i kërkesave nuk është bërë publik ndonëse ky i fundit ekziston. NjA. Cërrik ka facebook por që ka nevojë për përditësim të vazhdueshëm ndërsa NjA. Gostimë nuk ka. Në bashki ka një koordinator për informimin publik emri dhe kontaktet e të cilit nuk janë bërë publike pasi bashkia nuk ka ende një faqe zyrtare web-i. Në NjA-t pilot përgjegjës për informimin publik janë specialistët e informimit. Kërkesat e qytetarit për informacion sipas administratës janë trajtuar sipas ligjit duke respektuar afatet përkatëse të kthimit të përgjigjes.

Ndërkohë nga përpunimi i pyetësorëve rezultojnë gjetjet si më poshtë:

Gjetje sasiore:

- 20% e qytetarëve dhe 30% e Biznesit të anketuar në Bashkinë Cërrik e kanë konsideruar informacionin e regjistruar dhe të dokumentuar që ofron bashkia të mjaftueshëm për sigurimin e informimit publik të komunitetit.

- Në lidhje me trajtimin e kërkesave për informacion nga administrata publike e qeverisjes vendore për periudhën kohore 2015 – 2017, sipas të anketuarëve rezultoi se numri i kërkesave për informacion të refuzuara nga administrata ishte 6 (3 nga qytetarët dhe 3 nga biznesi i anketuar) dhe numri i kërkesave që nuk i është kthyer përgjigje ishte 5 (4 nga qytetarët dhe 1 nga biznesi i anketuar). Po në vijim të sa më sipër nga përpunimi i pyetësorëve rezultoi se 8% e qytetarëve të anketuar kanë pohuar se kërkesave të tyre për informacion nuk i është kthyer përgjigje fare.

- Sipas sistemit të vlerësimit me pikë 1-5, burimet më efektive të informacionit të ofruar nga administrata janë vlerësuar për 95% të qytetarëve të anketuar *zyrat* me (3.3 pikë), 97% e tyre kanë vlerësuar *njoftimet në mjediset e bashkisë e NjA-ve* me (3.1 pikë) dhe 88.3% kanë vlerësuar *shërbimin e informacionit në bashki* me (3 pikë).

- Në lidhje me tarifën e pagesës për kërkesat për informacion 30% e qytetarëve, 50% e biznesit dhe 100% e OJF-ve të anketuara kanë pohuar se nuk kanë paguar asnjëherë për informacionin e marrë.

50 Neni nr.20 pika 1 dhe 2 i ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/40-ligj-nr-139/2015-date-17-12-2015-per-veteqeverisjen-vendore

51 Ligji "Për konsultimin publik"

52 Platforma online e VKB-ve, http://www.vendime.al/

Gjetje cilësore:

- Nga takimet në komunitet rezultoi se qytetarët kishin pak njohuri për ligjin "Për të drejtën e informimin" dhe informacionin që ofronte bashkia e NJA-t pilot në drejtim të informimit të komunitetit.
- OJF-të në takime kanë pohuar se përdorin mirë faqen e facebook-ut të bashkisë dhe NjA-ve megjithëse informacioni që ofrojnë ato, sipas tyre, është i pakët.
- Qytetarët në takime kanë pohuar se administratat e NjA-ve pilot në përgjithësi e kanë respektuar afatin e kthimit të përgjigjeve të kërkesave të tyre kurse administrata qëndrore ka pasur vonesa, kthim përgjigje jo të saktë deri në moskthim përgjigje fare.
-

b. Ofrimi i shërbimeve

Gjetje sasiore:

- Në lidhje me garantimin e mekanizmave që sigurojnë cilësinë e shërbimeve nga ana e administratës në Bashkinë Cërrik vetëm 25% e qytetarëve të anketuar mendojnë se administrata i ofron shërbimet bazuar në studime të nevojave reale.
- 18% e qytetarëve, 20% e biznesit dhe 50% e OJF-ve të anketuara janë përgjigjur se e njohin mekanizmin e marrjes së mendimit qytetar (anketimet) për cilësinë e shërbimeve që ka përdorur administrata publike e qeverisjes vendore.
- Efektiviteti i administratës vendore në Bashkinë Cërrik nga 98.3% e qytetarëve të anketuar është vlerësuar 3.3 pikë (*nivel i kënaqshëm*) sipas shkallës së pikëzimit 1-5.
- Në lidhje me sigurimin e qasjes në shërbime të grupeve vulnerable nga ana e administratës, 43% e qytetarëve dhe 100% e OJF-ve të anketuara mendojnë se administrata siguron qasje në shërbime në përputhje me nevojat e tyre.

Gjetje cilësore:

- Komuniteti konfirmoi mungesën e shërbimit të çerdheve publike.
- Sipas komunitetit në shërbimin e kopshteve publike ka vend për përmirësim në drejtim të kushteve (gjendja e ndërtesave, sistemi i ngrohjes e pajisja) dhe shtrirjes gjeografike sidomos për NjA-t rurale. Kopshtet publike në dy njësitë pilot janë në ndërtesat e shkollave dhe varen nga ato me përjashtim të një kopshti në NjA-n Cërrik që është në godinë më vehte.
- Nga takimet qytetarët vlerësuan më shumë përsa i përket efektivitetit, profesionalizimit dhe etikës në punë shërbimin e ofruar nga administrata e NjA-ve se sa atë të administratës qëndrore të bashkisë.
- Nga anketimet në lidhje me kanalet e ofrimit të shërbimeve rezultoi se të tre target grupet (qytetarët, biznesi dhe OJF-të) përdorin më shumë *kërkesën*[53] për marrjen e shërbimit krahasuar me kanalet e tjera të ofruara nga administrata publike e qeverisjes vendore.

[53] Grafiku nr.11

- Shërbimi me shumë sportele (one-stop shop) funksionon dhe është i mirëfilltë në drejtim të shërbimeve në NjA-n Cërrik.
- Shërbimi administrativ i dhënies së lejeve dhe liçensave nuk ofrohet në NjA Gostimë dhe banorët i drejtohen Bashkisë Cërrik. Në lidhje me këtë shërbim përsa i përket procedurave qytetarët në takim kanë shprehur pakënaqësi përsa i përket kohëzgjatjes, dokumentacionit të shumtë dhe kostoja që e shoqëron.
- Shërbimet të vlerësuara me më shumë pikë[54]nga qytetarët dhe OJF-të e anketuara por edhe nga takimet në komunitet rezultuan gjendja civile dhe shërbimi i kopshteve publike të ndjekur nga shërbimi i aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike (NE) e aftësisë së kufizuar (AK). Për biznesin është vlerësuar me më shumë pikë, sipas shkallëzimit me pikë 1-5, vetëm trajtimi i kërkesave për leje të ndryshme.

C. Gjetjet kryesore

Në mënyrë të përmbledhur gjetjet më kryesore për të dy bashkitë janë si më poshtë:

- Nga përpunimi i pyetësorëve pjesëmarrja e target grupeve të anketuara në të dy bashkitë në procesin e konsultimit publik të projekt-akteve lokale rezultoi për qytetarët në kufijt nga 23 - 33%, për biznesin nga 18-30% dhe për OJF-të nga 27 – 100%. Pjesëmarrja më e ulët u vu re nga biznesi i anketuar që ushtron aktivitet në Bashkinë Tiranë me 18% dhe pjesëmarrja më e lartë rezultoi në Bashkinë Cërrik nga OJF-të me 100%.
- Nga takimet në komunitet rezultoi se një nga arsyet e shkallës së ulët të pjesëmarrjes është interesi dhe ndërgjegjësimi i ulët i qytetarëve për rolin e tyre në vendimmarrje.
- 46.3% e stafit të intervistuar të administratës së Bashkisë Tiranë dhe 55% e administratës së intervistuar të Bashkisë Cërrik e kanë vlerësuar pjesëmarrjen qytetare në procesin e konsultimit publik të projekt-akteve lokale të nivelit *të mjaftueshëm*.
- Format e njoftimit më të përdorshme gjatë procesit të konsultimit publik janë vlerësuar *njoftimet në mjediset e bashkisë dhe NjA-ve* nga 12.4% qytetarëve të anketuar në Bashkinë Tiranë ndërsa në Bashkinë Cërrik 20% e të anketuarëve kanë vlerësuar si më të përdorshme *faqen zyrtare të bashkisë* (facebook-un).
- Nga takimet në komunitet qytetarët në përgjithësi mospjesëmarrjen në konsultimin publik e justifikuan me faktin se nuk janë lajmëruar nga administrata publike e qeverisjes vendore.
- Vlerësimi me pikë (1-5) nga vet target grupet e anketuara i treguesve në bllok të përfshirjes së qytetarit në procesin e hartimit të politikave dhe projekt-akteve lokale (pjesëmarrja, marrja parasysh e rekomandimeve nga qeverisja vendore dhe ofrimi i informacionit për projekt-aktet gjatë procesit të konsultimit publik[55] rezultoi më i lartë nga të anketuarit në NjA-t pilot të zonave rurale krahasuar me ato urbane.
- Nga konsultimi i faqeve zyrtare në Bashkinë Tiranë format proaktive të informimit publik rezultojnë më të shumta se sa në Bashkinë Cërrik e cila nuk ka ende një faqe

[54] Tabela nr.6 e vlerësimit me pikë
[55] Tabela nr.1 e vlersimeve me pikë

zyrtare web-i. Pavarësisht kësaj qytetarët e anketuar njohin e përdorin më shumë si burime efektive të ofrimit të informacionit[56] *zyrat* dhe më pak *faqet zyrtare të bashkive e NjA-ve*. Pra informimi proaktiv është më pak i njohur dhe i përdorshëm sidomos nga grupet në nevojë që preferojnë formën tradicionale për shkak të nivelit arsimor, mundësive të kufizuara ekonomike dhe mungesës së aftësive të nevojshme.

- Në lidhje me trajtimin e kërkesave për informacion qytetarët gjatë takimeve në komunitet vlerësuan më shumë administratën e NjA-ve përsa i përket respektimit të afateve dhe më pak administratën qëndrore të dy bashkive pilot. Edhe nga anketimet rezultoi mosrespektimi i afateve të përgjigjeve nga administrata si dhe rastet e refuzimit dhe moskthimit të përgjigjeve ilustruar në grafikët nr.4 dhe 5.

- Treguesit e informimit publik të vlerësuar në bllok sipas sistemit me pikë (1-5) janë vlerësuar nga të anketuarit e NjA-ve rurale pilot me më shumë pikë se të anketuarit e NjA-ve urbane ilustruar kjo në tabelën nr.2 të vlerësimit.

- Në lidhje me transparencën, Bashkia Cërrik nuk e ka bërë publike ende këtë program. Në Bashkinë Tiranë megjithëse ka një faqe web-i të strukturuar mirë dhe që ofron mjaft informacion, në të cilin bën pjesë edhe programi i transparencës, vetëm 32% e të anketuarëve kanë pohuar se janë në dijeni të këtij programi. Kjo vërteton edhe njëherë aksesin e ulët të qytetarëve të anketuar në informacionin që ofrohet në mënyrë proaktive nga bashkia ndër të cilat është edhe programi i transparencës. Në vijim të zbatimit të transparencës, në mjediset NjA-ve pilot të dy bashkive gjatë zbatimit të projektit nuk u vu re afishimi i vendimeve të marra nga qeverisja vendore.

- Në lidhje me shërbimet publike e administrative që janë marrë në analizë të anketuarit në të dy bashkitë pilot, kanë vlerësuar me më shumë pikë kënaqësinë për shërbimin e gjendjes civile (3.2 – 4 pikë)[57]gjë e cila u shpreh edhe nga pjesëmarrësit gjatë takimeve në komunitet. Në këto takime pjesëmarrësit vlerësuan gjithashtu më të mira shërbimet e ofruara nga administratat e NjA-ve se sa administratat qëndore të bashkive pilot.

- Nga takimet me qytetarët por edhe nga intervistat me administratën rezultoi se shërbimi i çerdheve publike mungon në Bashkinë Cërrik ndërsa në Bashkinë Tiranë mungon në NJA-t rurale pilot dhe nuk plotëson nevojat në NjA-t urbane. Për shkak të numrit të kufizuar dhe kapacitetit të vogël në krahasim me nevojat ka pasur probleme gjatë sezonit të regjistrimit të fëmijëve.

- Shërbimi i kopshteve publike lë mjaft për të dëshiruar në NjA-t rurale të të dy bashkive pilot përsa i përket shtrirjes gjeografike, gjendjes së ndërtesave, kushteve, pajisjeve por herë pas here procedura e regjistrimit të fëmijëve është shoqëruar me probleme sidomos në zonën qytetare për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm të tyre në krahasim me nevojat.

- Procedura e aplikimit për përfitimin e Ndihmës Ekonomike, sipas mendimit qytetar të shprehur në takimet në komunitet por edhe nga një pjesë e stafit të administratës, megjithë krijimin e rregjistrit elektronik nuk është shkurtuar si kohë në mënyrë të dukshme.

- Në lidhje me trajtimin e kërkesave për leje dhe marrje liçense qytetarët në takime

[56] Tabela nr.3 e vlerësimit me pikë
[57] Tabela nr. 6 e vlerësimit me pikë

shprehën ankesa përsa i përket procedurave të gjata administrative, dokumentacionit të shumtë, shoqëruar shpesh me shpenzime, bllokimit të marrjes së lejeve për një periudhë kohore relativisht të gjatë (rasti i NjA. Petrelë) dhe pamundësisë së marrjes së shërbimit nga NjA-t duke qenë te detyruar shpesh t'i drejtohen zyrave të bashkisë qendrore. Ofrimi i shërbimit online të lejeve në përgjithësi nuk njihej nga qytetarët dhe biznesi i anketuar.

- Ndër kanalet e ofrimit të shërbimeve nga administrata e qeverisjes vendore përqindja më e lartë e të anketuarëve sipas grupeve (qytetar, biznes dhe OJF) në Bashkinë Cërrik kanë pohuar se kanë përdorur *kërkesën* për marrjen e shërbimit. Në Bashkinë Tiranë përqindja më e lartë e qytetarëve të anketuar kanë pohuar se kanë përdorur *kërkesën* kurse biznesi dhe OJF-të e anketuara në përqindjen e tyre më të lartë kanë pohuar se kanë përdorur *faqen zyrtare të bashkisë*.[58]

- Për mekanizmat e sigurimit të cilësisë së shërbimeve të përdorura nga administrata e qeverisjes vendore si dhe sigurimin e qasjes në shërbime të anketuarit e NjA-ve rurale pilot kanë dhënë sërish vlerësim[59] me më shumë pikë, me ndonjë përjashtim (psh biznesi i anketuar), se sa të anketuarit e NjA-ve urbane.

[58] Ilustruar në grafikët nr. 10 dhe 11

[59] Tabelat nr. 4 dhe 5 të vlerësimit me pikë

IX. REKOMANDIMET

A Rekomandimet e qytetarit

- Rritja e kopetencave të NjA-ve në mënyrë që të mos detyrohen t'i drejtohen zyrave të bashkisë qëndrore. (kjo sidomos për zonat rurale që kanë qenë ish Komuna)
- Rritja e masës së Ndihmës Ekonomike (NE).
- Bërja transparente e skemës së pikëzimit të përfitimit të (NE)
- Mbështetja e ofrimit të shërbimeve në një analizë të nevojave.
- Ngritja e shërbimit të çerdheve dhe përmirësimi i gjendjes së kopshteve publike në zonat rurale
- Përmirësimi i procedurës së dhënies së lejeve për punime të brend shme
- Krijimi i mundësive financiare për publikimin e gazetave lokale (falas), sidomos në NjA-t rurale, që do të ndihmonin në drejtim të informimit publik

B Rekomandimet për qeverisjen vendore – Bashkitë Tiranë dhe Cërrik

❖ Për përfshirjen e qytetarëve në procesin e hartimit të politikave dhe projekt-akteve lokale

- Të nxisin pjesëmarrjen qytetare nëpërmjet aktivizimit maksimal të strukturave si; ndërlidhësit e komunitetit, kryepleqtë dhe administratorët e pallateve të cilët ndihmojnë në mobilizimin, informimin dhe përfshirjen në iniciativa qytetare të komunitetit si dhe adresimin e kërkesave e shqerësimeve të tyre.
- Të ndërgjegjësojnë qytetarët për rolin e tyre në vendimmarrje.
- Të nxisin rritjen e besimit të komunitetit ndaj administratës publike të qeverisjes vendore.
- Të bëjnë publike në mënyrë të vazhdueshme rekomandimet e komunitetit që janë marrë parasysh gjatë procesit të konsultimit publik të projekt-akteve lokale.
- Ngritja e strukturës së ndërlidhësit të komunitetit në NjA. Cërrik në përputhje me ligjin "Për vetqeverisjen vendore".
- Ngritja e stendës së njoftimeve në ndërtesën e Bashkisë Cërrik dhe bërja publike e PPV dhe Buxhetit.
- Bashkia Cërrik të krijojë mundësinë e ofrimit të konsultimit publik online.

❖ Për informimin publik

- Gjetja e formave efikase për rritjen e komunikimit të administratës me qytetarët në të dy bashkitë pilot gjë e cila do të ndikojë dhe në rritjen e besimit të tyre tek administrata.

- Rritja e llogaridhënies së administratës kundrejt qytetarit të bëhet një prioritet i politikës së brëndëshme të qeverisjes vendore në të dy bashkitë pilot.
- Krijimi kanaleve të shumta të marrjes së informacionit nga qytetari, sidomos pë Bashkinë Cërrik, për të gjitha kategoritë në mënyrë të thjeshtë dhe jo të kushtueshme.
- Respektimi i afateve ligjore të kthimit të përgjigjeve të kërkesave për informacion dhe sipas formatit të kërkuar nga administrata e të dyja bashkive pilot.
- Për Bashkinë Cërrik publikimi në faqen zyrtare i programit të transparencës, VKB-ve, rregjistrit të kërkesave dhe emrit e kontakteve të kordinatorit për informimin publik
- NjA-t pilot të dy bashkive të ofrojnë më shumë informacion të përditësuar në Facebook dhe Gostima të përmirësojë informimin publik duke krijuar një faqe zyrtare (Facebook) pasi aktualisht nuk ka.
- Organizimi i vazhdueshëm i fushatave informuese të komunitetit për ligjin "Për informimin publik", format e informimit e sidomos atë proaktiv për të rritur qasjen e qytetarit drejt tyre.
- Gjetja e formave dhe krijimi i lehtësirave që ndihmojnë në rritjen e aksesit në informacion të qytetarëve e sidomos të grupeve në nevojë.

❖ Për ofrimin e shërbimeve – sigurimi i mekanizmave që garantojnë cilësinë

- Realizimi në mënyrë periodike i anketimeve për cilësinë e shërbimeve dhe bërja publike e rezultateve në të dy bashkitë pilot.
- Rishikimi dhe përmirësimi i shërbimeve publike dhe administrative bazuar në vlerësimin e mendimit qytetar.
- Matja periodike e kënaqësisë së qytetarit për shërbimet.
- Ofrimi i shërbimeve mbi bazën e studimit të nevojave reale të komunitetit.

❖ Për ofrimin e shërbimeve – sigurimi i qasjes në shërbime

- Sigurimi i qasjes fizike të personave me aftësi të kufizuar (AK) në mjediset e 2 NjA-ve pilot (Dajt dhe Petrelë).
- Mundësimi i shërbimit të çerdheve publike në 2 NjA-t rurale pilot në Bashkitë Tiranë dhe Cërrik dhe plotësimi i nevojave me këtë shërbim në NjA-t urbane të Bashkisë Tiranë.
- Përmirësimi i shërbimit të kopshteve dhe shpërndarja e drejtë gjeografike e tyre në NjA-t rurale pilot të dy bashkive.
- Ngritja e shërbimit me shumë sportele (one-stop shop) në njësitë administrative e sidomos ato rurale në të 2 bashkitë pilot.
- Rritja e qasjes në shërbime nëpërmjet shtimit të e-shërbimeve.
- Përmirësimi i performancës dhe efektivitetit të administratës publike të qeverisjes vendore e sidomos asaj qëndrore të dy bashkive.

C Rekomandime për qeverisjen qëndrore

- Krijimi i mundësive për rritjen e masës së përfitimit të ndihmës ekonomike.
- Bërja transparente për qytetarin e skemës së pikëzimit të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe orientimit për apelim në rast ankese.

D. Për institucionet e pavarura të administratës publike

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të monitorojë zbatimin e ligjit "Për të drejtën e informimit" nga Bashkia Cërrik përsa i përket krijimit të faqes zyrtare të web-it, publikimit të programit të transparencës, rregjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, dhe emrit dhe kontakteve të kordinatorit të informimit publik.

X. BIBLIOGRAFIA

- Ligji "për njoftimin dhe konsultimin publik" neni 6 pika 1, neni 11 pika 1 dhe 2 dhe neni 20 pika 1 gërma (c), *https://www.akep.al/images/stories/AKEP/legjislacioni/LIGJ-Nr146-2014-010515.pdf*
- Ligji "Për të drejtën e informimit", për koston e shërbimit neni 13 pika 1 dhe 2, për afatin e kërkesave për informacion, neni 15 pika 1 dhe 2 *www.dap.gov.al*
- Sondazh për pjesëmarrjen në konsultimet publike për PPV – faqja zyrtare e Bashkisë Tiranë *www.tirana.gov.al*
- Ligji nr. 139/2015 "për vetqeverisjen vendore" neni 15 pika 2, neni 16 pika 1, neni 19 pika 2, neni 20 pika 1 dhe 2, neni 23 pika 12, neni 24 pika 1 *http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/40-ligj-nr-139/2015-date-17-12-2015-per-veteqeverisjen-vendore*
- Raporti i studimit të implementimit të ligjit 119/2014 në 61 bashki të Republikës së Shqipërisë realizuar në vitin 29017 nga Qendra për Cështje të Informimit Publik – INFOCIP *http://www.infocip.org/al/wp-content/uploads/2017/10/Raporti-implementimi-i-ligjit-119-nga-61-bashkite-e-RSH.pdf*
- Kushtetuta e Shqipërisë 2016 neni 23, pika 1 dhe 2 mbi garantimin e të drejtës së informimit *http://www.pp.gov.al/web/kushtetuta_2016_1082.pdf*
- Të dhëna për bizneset dhe OJF-t e rregjistruara në Bashkinë Tiranë *http://opendata.tirana.al/?q=search/field_topic/ekonomia-3*
- Të dhëna për profilin e Bashkisë Tiranë dhe Cërrik dhe 6 NjA-ve pilot janë marrë nga *http://zgjedhje2015.reporter.al/profili-i-bashkise-Tirane/*
- Sondazh për cilësinë e shrbimit të sporteleve të sektorit të pritjes dhe komunikimit me qytetarin në bashkinë Tiranë *http://www.tirana.al/publikimepdf/Sondzh%20mbi%20sherbimin%20ne%20Sektorin%20e%20Pritjes%20dhe%20Komunikimit%20me%20Qytetaret.pdf*
- Platforma online e VKB-ve, *http://www.vendime.al/*
- SIGMA, Parimet e Administratës publike - *http://www.sigmaweb.org/publications/Principles-Public-Administration-Overview-Alb.pdf*
- Rregjistri i kërkesave dhe përgjigjeve të Bashkisë Tiranë, *http://www.tirana.al/programi-transparences/regjistri-i-kerkesave/*

XI. SHTOJCA - A

Në këtë shtojcë jepet informacion shtesë i ilustruar me tabelat e mëposhtme për numrin e pyetësorëve dhe intervistave të realizuara sipas bashkive dhe NjA-ve pilot, përqindjen e qytetarëve, OJF-ve dhe bizneseve të anketuara. Për Bashkinë Cërrik nuk u mundësua numri i bizneseve të rregjistruara që do të na lejonte në përcaktimin e përqindjes që zënë bizneset e anketuara.

Tabela e realizimit të pyetësorëve dhe intervistave sipas bashkive dhe NjA-ve pilot

Bashkitë dhe NjA-t pilot	Gjithsej	Pyetësorë			Intervista
		Qytetari	Biznesi	OJF-t	Administrata
Bashkia Tiranë	**253**	**194**	**44**	**15**	**41**
NjA. Nr.5	86	86			
NjA. Nr.6	69	69			
NjA. Dajt	20	20			
NjA. Petrelë	19	19			
Bashkia Cërrik	**72**	**60**	**10**	**2**	**11**
NjA. Cërrik	60	48	10	2	
NjA. Gostimë	21	21			
Totali	**325**	**254**	**54**	**17**	**52**

Përqindja e qytetarëve të anketuar kundrejt totalit të popullsisë[60] mbi 18 vjeç

Njësitë e qeverisjes	Popullsia mbi 18 vjec	% e të anketuarëve
Bashkia Cërrik	35,813	0.16
Njesia Administrative Cërrik	11,833	0.32
Njesia Administrative Gostime	9,684	0.21
Bashkia Tiranë	632,730	0.03
Njesia Administrative Nr. 5	69,813	0.12
Njesia Administrative Nr. 6	55,941	0.12
Njesia Administrative Dajt	11,704	0.17
Njesia Administrative Petrelë	4,951	0.38

[60] Popullsia mbi 18 vjeç sipas Drejtorisë së Prgjithshme të Gjëndjes Civile për vitin 2016

Përqindja e bizneseve dhe OJF-ve të anketuara kundrejt totalit të rregjistruar[61]

Biznesi dhe OJF-të	Të rregjistruara	Të anketuara	% e të anketuarëve
Bizneset Bashkia Tiranë	41583	44	0.10
Njësia Administrative nr.5	36189	24	0.07
Njësia Administrative nr.6	36189	13	0.036
Njësia Administrative Dajt	589	5	0.8
Njësia Administrative Petrelë	106	2	1.9
OJF-t			
Bashkia Tiranë	2209	15	0.7
Bashkia Cërrik	2	2	100

[61] Të dhënat janë marrë nga portali Open Data http://opendata.tirana.al/?q=search/field_topic/ekonomia-3

XII. SHTOJCA – B

PROBLEMET E NGRITURA NGA QYTETARËT GJATË TAKIMEVE NË KOMUNITET

Bashkia Tiranë:

- Mungesa e shërbimit të çerdheve publike në NjA-t rurale pilot dhe mosplotësimi i nevojave për këtë shërbim në NjA-t urbane.
- Procedura e regjistrimit në çerdhe ka paraqitur probleme në NjA-t urbane për shkak të numrit dhe kapacitetit të kufizuar të çerdheve.
- Shërbimi i kopshteve dhe shkollave publike në NjA-t urbane, nisur nga eksperiencat e banorëve prezent në takim, u vlerësuan si shërbime normale. Në zonat rurale pilot ky shërbim lë për të dëshiruar përsa i përket kushteve (gjendja e ndërtesave, pajisjet etj), shtrirjes gjeografike dhe plotësimit të nevojave. Zona e Qesarakës në NjA-n Dajt, si zonë e re urbane rezultoi e zbuluar me shërbimin e çerdheve dhe kopshteve publike. Në fshatin Gurë e madhe të NjA-s Petrelë, gjendja e kopshtit nga banorët u paraqit në kushte shumë të këqija. Edhe në këtë shërbim sipas qytetarëve procesi i regjistrimit ka pasur raste problematike për shkak të drejtuesve të këtyre institucioneve por edhe të nevojave në rritje krahasuar me mundësitë e ofruara.
- Papunësia është një problem tjetër i ngritur nga banorët që nuk gjen zgjidhje. Ky problem është më i madh për të rinjtë në NjA-rurale të cilët janë jo shumë të informuar edhe për mundësitë që u ofron zyra e punës.
- Procedura dhe dokumentacioni i aplikimit për të përfituar nga programi i strehimit nga të pranishmit në takime u cilësua e gjatë dhe me një numër të madh dokumentesh që shpesh marrja e tyre është e kushtueshme ndërkohë që përgjigjet e aplikimit vijnë me vonesë (prej disa muajsh dhe ndonjëherë iu kërkohet përsëritja e dokumentacionit pa asnjë shpjegim).
- Vaditja është një problem madhor për banorët e NjA-ve rurale pilot sidomos për ata që banojnë në zonën kodrinore dhe e kanë tokën mbi ujë gjë që ndikon në aktivitetin bujqësor të banorëve. Mirëmbajtja e kanaleve kulluese nga bashkia sipas banorëve lë shumë për të dëshiruar.
- Probleme me tokën, përsa i përket regjistrimit të saj. Shkresat e nevojshme duhet të dërgohen në Bashkinë Tiranë. Procedurat administrative janë të kushtueshme, të komplikuara dhe të gjata që shpesh i kalon të 10 ditët e përcaktuara me ligj.
- Kompetencat e kufizuara të administratës së njësisë administrative. Të pranishmit shprehën opinionin e tyre për rishikimin e ligjit për vetëqeverisjen vendore në mënyrë që të rriten kompetencat e njësisë administrative, kjo sidomos për NjA-t rurale që kanë qenë komuna.
- Zyrat e administratës qëndrore të bashkive sipas të pranishmëve në takime e kanë zvarrisur zgjidhjen e problemeve që ata kanë pasur në rastet kur i janë drejtuar atyre.
- Në lidhje me pagesën e taksave e tarifave banorët e NjA. Petrelë ngritën problemin se tashmë nuk mund të mbarojnë punë pranë njësisë së tyre ku banojnë, pasi ajo nuk ka më kompetenca, por i duhet të shkojnë në zyrat e bashkisë qëndrore në Tiranë.

- Taksat e tokës janë shumë të larta dhe shpesh banorët ngarkohen me pagesë kamatë vonese ndonëse nuk kanë marrë asnjë njoftim paraprak nga bashkia qëndrore (rasti i Petrelës).
- Pastrimi i mjedisit është në nivel të ulët në NjA. Petrelë. Punonjësit për pastrim vijnë nga Tirana pasi njësia nuk ka më kompetenca për këtë shërbim. Mbledhja e mbeturinave bëhet një herë në javë/ muaj. Edhe kazanët e mbeturinave shpesh mungojnë ose janë gjithnjë të mbingarkuara.
- Infrastruktura e rrugëve në NjA. Petrelë që lidh fshatrat është shumë e keqe dhe ka nevojë për ndërhyrje.
- Procedura e marrjes së lejeve për punime nga qytetarët u konsiderua e gjatë, që zgjat në kohë, shpesh e kushtueshme dhe nuk plotëson nevojat imediate. Në NjA. Petrelë sipas banorëve dhënia e lejeve është bllokuar prej rreth 1 viti nga Bashkia Tiranë.

Bashkia Cërrik:

- Shërbimi i çerdheve publike mungon komplet në NjA-t pilot të Bashkisë Cërrik. Nevojat për çerdhe pavarësisht se nuk janë të dukshme (për shkak të papunësisë) janë ekzistente pasi në diskutim qytetarët (gratë sidomos) janë shprehur se nuk mund të pranojnë një vend punë për shkak se kanë fëmijë të vegjël për të mbajtur.
- Përsa i përket shërbimit të kopshteve publike në këtë bashki në lidhje me kushtet e tyre banorët në takime u shprehën të kënaqur pasi bashkia e ka siguruar ngrohjen gjatë dimrit. Problem u evidentua nevoja e pajisjes së fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptianë me bazë materiale.
- Papunësia edhe në këtë bashki është problem. Banorët janë shprehur në takime se është shumë e vështirë gjetja e punës në një kohë kur kërkesat janë shumë të mëdha e sidomos nga të rinjtë. Pjesa më e madhe e banorëve në NjA. Gostimë janë të vetëpunësuar në bujqësi megjithatë kushtet për punësimin e të rinjve janë të pakta.
- Në lidhje me procedurat administrative për marrje certifikatë të viteve 72 e më parë, kartë papunësie, etj banorët tashmë nuk mund të mbarojnë punë në njësitë e tyre administrative ku banojnë, pasi ajo nuk e ka këtë kompetencë, por i duhet të shkojnë në zyrat e institucioneve përkatëse në Elbasan. Kjo për banorët është me kosto dhe rrit vështirësitë dhe kohën për të përfituar shërbimin.
- Strehimi është shoqëruar gjithashtu me probleme. Lind nevoja e pajisjes me tapi të banorëve që aktualisht jetojnë në ambientet e shkollës së natës ose ndërmjetësimi tek institucioni respektiv i cili ka në varësi godinën.
- Banorët në takime ngritën dhe nevojën për shtim të shërbimeve në spitalin e qytetit të Cërrikut me qëllim shmangjen e vajtjeve në qytetin e Elbasanit për përfitimin e këtyre shërbimeve. Nga gratë e komunitetit u ngrit gjithashtu edhe problemi i mungesën së shërbimeve për gruan dhe nënat e reja.
- Në NjA. Gostimë biznesi lokal ka hasur vazhdimisht shumë vështirësi për shkak të mungesës së energjisë elektrike. Kjo pasi pika e shpërndarjes është në zonën e Gjinarit dhe problematikat që i ndodhin transformatorit atje ndikojnë edhe në këtë zonë.

Qendra “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”

Raporti “Vlerësimi qytetar për administratën publike të qeverisjes vendore”

Mbështetur nga :

Bashkimi Evropian dhe Mbretëria e Holandës

Tiranë, Dhjetor 2017

51 faqe

Format: 20.4 x 290 cm